



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Dana 20.04.2026			
Nr. Organi Org. Broj	Numri Broj	Shtetesi Prosti	Vlera Vrednost
01-	016/01-		461



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e V të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **30.04.2026, (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin (Rialokimin) e mjeteve buxhetore në programin buxhetor në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
7. Pyetje dhe përgjigjeje

Viti, më 22.04.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

1



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KATËRT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryesuesi, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja u mbajt më 30.03.2026 (e hënë), në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar nga ora 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi; kryetari i Komunës, z. Sokol Haliti; nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu; drejtorët komunalë; si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, znj.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Rama, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, zn.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, zn.Liridona Bislimi, z.Remzi Salihu, z.Labinot Bislimi, z.Elham Emërllahu, ndërsa mungoi, z.Sokol Shaqiri.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katër të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Materialin e keni marrë me kohë për këtë seancë, dhe pak para se me fillu këtë pjesë, po ju njoftoj se, kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë, po e kemi një rast që u kthy jo i ligjshëm, që e kemi pikë të rendit të ditës, që duhet me shfuqizua, ndërsa tjerat vendime janë në rregull. Vazhdojmë me rendin e ditës.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0 me sipërfaqe 17758 m² në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jete parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m².
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e deklaratës mbështetëse për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
7. Pyetje dhe përgjigjeje

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Për rend të ditës a ka me diskutu? Pasi që nuk ka për diskutim për rend të ditës: a jeni që të miratohen rendi i ditës me materialin që e keni marr me pikat e rendi te ditës? Pra, me 25 vota pro miratoht rendit i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: A jeni që të miratohet procesverbali? Pra, nga të gjithë të pranishmit me vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Zakonisht pronat që mund të jepen në shfrytëzim ose mund të lihen si hapësirë, sipas ligjit, duhet të miratohen deri në dhjetor për vitin vijues. Ato lista të jenë lista zyrtare, që jepen në shfrytëzim. Për shkak vitit zgjedhor që ka qenë nuk ka mujtë të behen në muajin dhjetor, dhe i ka dhanë në muajin mars. Kjo listë duhet të miratohet çdo vit, sepse për çdo vit e ka afatin.

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ashtu si e ceku edhe kryesuesi, afatet ligjore janë siç kanë qenë. Lista e pronave të paluajtshme të planifikuara për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026 përfshin disa zona të ndryshme të komunës, të shpërndara në lokalitete të ndryshme me potencial zhvillimor. Pronat janë në këto zona kadastrale dhe vendbanime: Zhiti, Devajë, Smirë, Tërpezë, Drobesh, Sodovinë e Qerkezëve dhe Sllatinë. Këto prona janë të parapara për shfrytëzim në fusha të ndryshme, si bujqësi, pylltari dhe aktivitete tjera ekonomike, me qëllim të nxitjes së zhvillimit lokal dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ashtu si e dini, këto prona janë vetëm të planifikuara. Çdo parcelë e cila shpallet në ofertë për dhënie në shfrytëzim do të rikthehet, çdo parcelë veçmas, të cilat do ta keni mundësinë për shqyrtim, dhe komisioni do të përbëhet nga anëtarët e Kuvendit për procedurat që do të udhëhiqen.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kësaj liste sot ja kemi bashkëngjitur edhe një parcel, e cila gjendet në Germovë. Është mirë sekretaria me shpërnda në Kuvend, pasi që kemi të bëjmë me afatin e fundit. Edhe kjo parcelë të i bashkangjitet regjistarve për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Hapi diskutimin.

z.Labinot Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në këtë pikë unë do të doja t'i ngrit disa çështje. E para e punës, në aspektin procedural, a mund të bëjmë nga ana e kundërt që njëherë të njoftohemi qartazi për secilën parcelë se për çfarë është fjala dhe, në një seancë tjetër, të votojmë, si kjo mënyrë e votimit siç është sot? Siç e dëgjova drejtoreshën, do të na paraqitet në një seancë tjetër çështja e parcelave. Unë mendoj që më së pari duhet me na u paraqit element për element secila parcelë dhe me një seancë të dytë ta bëjmë votimin e përbashkët. Dhe tjetra është në përmbajtje, aty te dokumentet që na i keni ofru parcelat shihet që janë bujqësi, pylltari etj., por një element që nuk e kam mirë të qartë është që gjithmonë në një pjesë aty ku shkruan se është një posedim individual. Çka nënkupton me posedim individual, se kjo parcelë merret prej individëve, personave fizikë, dhe jo prej personave moralë apo, siç i quajmë në Kosovë, persona juridikë? A ka të bëjë që njerëz të caktuar, me emër e mbiemër, sikur unë, ta marrin parcelën, apo janë persona juridik që janë ferma, kompani etj., etj.? Se kjo është një çështje serioze, të ju jepen parcelat individëve, personave fizikë dhe jo personave juridikë. Mua më duket jo fort e logjikshme dhe nuk e di a është ligjore kjo punë. Dhe te kjo pika e dytë e përmbajtjes, p.sh., kur themi pyjet ju jepen në posedim, nuk e dimë kujt, por kryesisht ju ipen individualisht. Është e paqartë çka ka me bë, çfarë veprimtarie ka me bë ai me pyje, aspektet e pylltarisë, se duhet me na qartësu këtë element: çka ka me shfrytëzu, cila është veprimtaria reale për shfrytëzimin e parcelës. Dhe tjetra, ku unë jam plotësisht në kundërshtim, ku pres me detaj me na shpjegu se për çfarë është fjala, po është në zonën industriale. Unë mendoj që ajo zonë që ju e quani industriale, apo pak me terma ndryshe zonë ekonomike, e kam thanë, po e them përsëri, duhet me u zhbë, duhet me u ndërru vendi, sepse ajo është në një pellg dhe është kundër ambientit, por edhe kundër zhvillimit ekonomik të Vitisë. Po ia shtojmë kësaj edhe rrezikun e përmbytjeve etj. Mendoj që njerëzit nuk duhet me i shti në këto kurthe, që mos të investojnë në atë pjesë. Dhe unë do të bëj çmos, siç kam premtu edhe përmes fushatës, që ajo zonë industriale me shku përballë drejtësisë

dhe faktikisht me pas përndjekje nga krimet ekonomike, sepse është e papranueshme që aty të ketë zonë industriale dhe të shtyhen proceset në atë drejtim. Në këtë pikë, hiq pa e pa se për çka është fjala, cila kompani apo kush është ai që pretendon me investu aty, unë kundërshtoj hapur dhe pres prej asamblistëve tjerë që të votojnë gjithashtu kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Çështja e zonës është çështje e mbyllur, nuk është në listë për dhënie në shfrytëzim. Lista e pronave është listë komunale, nuk ka prona të pylltarisë, por janë prona komunale që komuna i ka në dispozicion dhe i paraqet në listë, sepse nuk ka mundësi me i dhanë në shfrytëzim. Gjatë vitit, nëse ka kërkesa të caktuara prej njerëzve që investojnë, prej investitorëve të huaj, prej kompanive të ndryshme që dojnë me investu në Kosovë, atëherë përcaktohet aty ku është interesi, bëjnë kërkesë në komunë, fillojnë procedurat prej fillimit për çdo parcelë veç e veç dhe fillojnë procedurat, vijnë në Kuvend, formohet komisioni, janë procedura të veçanta. D.m.th kjo është veç si listë që mbetet në ueb-faqen e komunës, përcakohen pronat për investim gjatë vitit në prona komunale. Me vite ndoshta kemi miratu prona të njëjta, se ndoshta s'ka pas interes dikush me investu, mirëpo nëse ka interes, nuk e ke një listë të caktume, investitori nuk mundet as me aplikë, sepse nuk i ke dhanë hapësirë. Kjo është një listë që e përcakton komuna që ka hapësira të veta dhe e bëjmë vetëm si mundësi gjatë vitit kalendarik.

znj.Elsa Jahija: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, meqenëse në këtë seancë, konkretisht në këtë pikë të rendit të ditës, kemi për aprovim listën e pronave të cilat komuna e Vitisë planifikon t'i japë në shfrytëzim në rast të shprehjes së interesit nga bizneset me qëllim të krijimit të kushteve për vende të reja të punës, dëshiroj të ngrit një çështje që e konsideroj me rëndësi. Duke u bazuar në praktika të deritanishme, komuna ka dhënë edhe më parë prona në shfrytëzim mbi bazën e projekteve investive, megjithatë konsideroj që sot është e arsyeshme të paraqitet një pasqyrë më e qartë në ato prona kanë fillu investimet e parapara dhe nëse janë përmbushur obligimet e përcaktuara me marrëveshje. Kjo është e rëndësishme për t'u siguruar që pronat komunale të shfrytëzohen në funksion të interesit publik dhe zhvillimit ekonomik e jo të mbeten të paaktivizuara, të mos japin efektin e prituri apo të mbahen peng për interesa të ngushta. Prandaj konsideroj që, nga ana e komunës dhe drejtorisë përkatëse, duhet të ketë një qasje më të strukturuar, duke përcaktuar për secilën pronë afate të qarta investive dhe duke angazhuar një komision monitorues që të përcjell zbatimin e marrëveshjes dhe realizimin e projekteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Çdo pronë që jepet në shfrytëzim bëhet kontrata, vendimi, bëhet hapësira, përcakohet periudha kohore kur e ka fillimin, sa vjet e ka për me fillu investimin. Nëse nuk i ka zbatu në momentin që i kalon kontrata, ajo pronë merret. D.m.th ka plotë raste që veç janë edhe në të kaluarën.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në lidhje me pikën që jemi tu diskutu, si grup parlamentar i LDK-së ne do ta përkrahim për shumë arsye, sepse, siç e ceke edhe ti, kryesues, është interes i qytetarëve. Dmth ne duhet të jemi të gatshëm që të kemi hapësira, nëse një investitor mundet me na ardhë, të kemi hapësira ku investitorin ta lejojmë ta ngrit projektin e vet të cilin e ka. D.m.th është një interes për qytetarët. Por, përveç kësaj, kjo po kalon në shumë filtra të tjerë, dmth nuk është këtu menjëherë që ne jemi tu i dhanë këto prona, por për momentin jemi tu i shti në listë dhe, në momentin që ata shohin interes, ata mund ta bëjnë këtë dhe kanë me qenë transparente. D.m.th është komisioni dhe do të kthehet prapë në Kuvend. Prandaj, ne jemi për miratimin e kësaj pike të rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Këtu e kemi propozim-vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Këto prona nuk jepen për vitin 2026 dhe këtu nuk i kemi të cekura për sa vite do të ipen këto prona. Prej disa pronave specifike që kemi pasë vitin e kalum dhe vitin 2024 kemi pasë problematikë më të madhe te dhënia, se për sa vite do të ipen këto prona, se kemi pasë propozime këtu për 99 vite dhe për këtë kemi pasë kundërshtime më të mëdha. 99 vite nuk është me ia dhanë në shfrytëzim, por me ia falë dikujt pronën dhe, nëse janë 99 vite, veç ta dimë të vërtetën se çka ndodh me këto prona. E para është kjo që unë nuk besoj në këtë qeverisje që nuk e bën këtë, se ka tentu me bë dhe me dokument madje. Dhe, a e keni bë ndonjë analizë të pronave që keni dhënë më herët dhe sa është interesi ekonomik i komunës? A ia keni qëllu apo duhet me ndryshu diçka në strategji, në terren, me parcela, me pjesë të ndryshme? Jam plotësisht dakord me Labin, këto brenga i kam dhe ne si grup

parlamentar është mirë të bëhet një diskutim publik pak më i hapur rreth dhënies së pronave dhe interesave të komunës, ku është më mirë me dhanë. Më kujtohet që ka pasë shumë fermerë apo një banor të fshatit Devaj, për shkak të dhënies së komunës në disa prona, s'kanë mujtë tokat e veta me i punu, se është dashtë aty pari me kalu dhe pronari që ka pasë në posedim, pra shfrytëzim nga komuna, nuk e ka leju atë të kalon dhe kjo duhet të rregullohet me dokument, se njerëzit megjithatë e kanë tokën, pronën e vet dhe dikush e merr në shfrytëzim e kufizon atë. Dhe kjo punë e Gërmovës, qysh u bë kjo me shtu edhe nja e, kur të shtohet edhe një, të gjithë e dimë që ka interes, dikush e ka shty dikush, e tani kjo bie ndesh me strategjinë e komunës, kështu, ose me pas një arsyetim më të fortë. Ndërsa kemi gabime teknike te dokumenti: dy parcelat që janë atje në Sadovinë të Muhaxherëve, që kufizohen me Komogllavë-Ferizaj e Kaçanik, në të dyja aty e keni—njëra në gjeoportel del me një shifër, e fundi del 8, ndërsa këtu në dokument është tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Shënon këtu afat shkurt dhe afatgjatë. Nuk e di që kemi dhanë në Kuvend për 99 vite. Deri 35 vite kemi dhanë një pronë, zakonisht kemi dhanë 10 - 15 vite.

zn.Mirjeta Hamiti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Dua të lidhem konkretisht me njësinë kadastrale në Drobesh, në të cilën po ceket që, prona e cekur duhet të jepet në shfrytëzim, në destinim për tregun e kafshëve. Si ka mundësi të jepet për tregun e kafshëve, kurse kërkesë e banorëve të Drobeshit është që të largohet për shkak që është përball varrezave të fshatit. A ka mundësi të bëhet një park për fshatin, e jo me u bë tregu i kafshëve.

zn.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, gjithashtu edhe përfaqësuesit e mediave, edhe pse nuk janë prezent, informim përmes mediave për punën që bëjmë për qytetarët, përkundër faktit që interesi i tyre sot për sot është me i ndëgju problematikat dhe çështjet që i prekin direkt ata. Sa i përket pikës, ne kemi diskutu, i nderuari kryesues, edhe te KPF-ja dhe këtu e përmende prap që kjo listë është dashtë të vie në dhjetor, por natyrisht arsyetimi juaj ka qenë për shkak të fushatës zgjedhore është shty, por tani jemi në muajin mars. Pika e parë: kjo ka ardh me vonesë dhe duhet me ditë për çka ka ndodh që ka ardh. Keni përmend që lista është e njëjtë e vitit të kaluar, por që janë shtu vetëm Zhiti(a) dhe Sllatina te KPF, tash e keni sjellë edhe një pjesë tjetër, parcela në Gërmovë. Nëse nuk gaboj, gjatë mandatit të kaluar ka qenë kjo pjesë planifikim për me u ndërtu një objekt, të cilin na e keni prezentu krejt diçka tjetër, në fund e mbaj mend që ne anëtarët e Komitetit kemi bë një analizë dhe kemi kuptu që në fund po del një realizim krejt diçka tjetër. Unë po shpresoj që mos me u përsërit prap kjo. Një çështje tjetër që desha me diskutu është që këto parcela kemi pas raste që janë dhanë në shfrytëzim, por nuk ka shku në destinim tamam ajo çka është prezantu. P.sh., ta përmendim një temë: në fshatin Drobesh ka kohë të gjatë që janë dhanë parcelat për trafo elektrike. Kjo ka dalë këtu, ne e kemi votu si Kuvend, ka kalu, banorët e kanë marrë si punë të kryer, mirëpo deri tani nuk ka asnjë informat se çka ka ndodh; trafo nuk është. Unë e di që përgjigjja që keni me dhanë është përgjegjësi e KEDS-it dhe KEDS është kompani private, mirëpo ju si institucion që jeni në atë parcelë që keni dhanë është mirë me pas informat se çka ka ndodh. KEDS e ka marrë qe një kohë, normalisht ajo është në shfrytëzim, por mandej tani, a ka ndodh në praktik diçka? Jo. Banorët janë duke e vuajt këtë pjesë. Dhe tek çështja e tregut të kafshëve, pajtohem me parafolësen, bashkëfshataren: në fshatin Drobesh ka pasë ankesa të vazhdueshme, për shkak se as kushtet minimale ky treg i kafshëve nuk i përputh. Nuk pajtohem, dmth gjindet shumë afër varrezave dhe nuk ka hapësirë për mbeturina e për ujësjellës e gjëra tjera. Tash ju, në vend se me tentu me ndryshu, ju po kërkon me dhanë ende më shumë parcela, përkundër faktit që e dimë se në çfarë gjendje të mjerueshme është ai vend. Unë pajtohem me përfaqësuesin e AAK-së, mendoj që kjo pikë duhet me u shty, duhet me ardh prap në mënyrë më të specifikume që me ditë se çka po bajmë me këto parcela, se është pronë komunale, shtetërore dhe mbi të gjitha është në interes të madh të qytetarëve.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Asnjë pronë jashtë planit zhvillimor nuk mundet me u bë asgjë. Plani zhvillimor është i miratum, dhe kur të jepen në shfrytëzim, në bazë të planit zhvillimor jepen.

z.Elham Emërllahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit gjithashtu. Një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme, për të cilën unë i kam shqetësimet e njëjta sikurse parafolësit e mi. E para, po flasim për një çështje me rëndësi. Prona është e shenjtë, si ajo private e sidomos kjo shtetërore. Destinimi është shumë me rëndësi, dmth nuk kemi marrë shumë informata: a ka pasë në të kaluar prona të cilat janë dhanë dhe si janë shfrytëzu

dhe cili është interesi i qytetarëve ose i komunës në këtë rast? Po e shoh, kryesues, që po mundohesh me dhanë ti sqarime dhe përgjigje; leja drejtoreshës, ekzekutivit, sepse është punë e tyre, se po flasim për një temë që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe nuk kemi nevojë as me kriju ngut, as me u mundu me arsyetu, sepse për të gjithë neve është interes i përgjithshëm. Nëse ipet për shfrytëzim, sepse këtu thuhet për krijimin e vendeve të reja të punës, cili është saktësisht interesi, cilat janë të hyrat? Se ka pasë edhe në të kaluarën që janë dhanë. Atëherë ne e përkrahim; përndryshe, pa pas informacionet e sakta se cili është interesi i komunës dhe cilat janë të hyrat nga këto prona të cilat ipen në shfrytëzim, nuk mundem me përkrah. Po jepju hapësirë ekzekutivit me i sqaru, kryesues.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Elham! Qaq shumë kam përvoj në këtë, i di këto, për këtë po e sqaroj.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës: Faleminderit kryesues të nderuar, të pranishëm. Kësaj i ka parapri një punë e madhe që e ka bërë qeverisja komunale, sidomos vitin e kaluar, që ka prodhuar dokumente strategjike për zhvillim ekonomik lokal, planin zhvillimore komunal urban e dokumente të tjera. Tash vetëm janë nënshkruar hartat zonale, pritët shumë shpejt me dalë në debat, e aspektet e tjera që kemi punuar permanent. Përmbajtja e re që është tash nuk ka qenë në vendimin dhe miratimin e këtyre dokumenteve strategjike për 10-vjeçarin e ardhshëm, por një pjesë ka qenë, por kjo nuk është relevante. Me rëndësi është që ato dokumente janë prodhuar dhe ne duhet me shkuar në progres të zhvillimit ekonomik, mirëqenien sociale, mundësinë me ju krijuar hapësirë investitorëve. Tash ne kemi detyrim institucional si qeveri komunale, si ekzekutiv, që pas 2-3 debateve për me dorëzu listën e pronave që qeverisja komunale mendon që mund të ipen në shfrytëzim, tash afatmesëm, afatshkurtër, afatgjatë, vendos Kuvendi. Ka procedura të cilat duhet me i respektuar, të cilat ne i respektojmë, për shkak se Kuvendi delegon dhe përfaqësues në komision, në monitorim etj. Ka afate, dinamikë implementimi, komision monitorues. Në fakt, ua kemi marrë pronat të cilat nuk e kanë respektuar afatin që e kanë marrë. Ka aspekte juridike, komisione profesionale të vendosura nga Kuvendi dhe administratë që do të vendosin për këtë aspekt. Me të drejtë e dëgjova këshilltaren për çështjen e tregut, dhe ajo temë nuk është tabu me diskutu. Ne mundemi me bë një lokacion tjetër, a mundemi me bë më të mirë, a mundemi me i rregullu infrastrukturën ose me nxjerr donacion. Por tani për tani ne po flasim për listën, të cilën e kemi për detyrim me ia dorëzu Ministrisë, por përmes Kuvendit, i cili është organi kryesor që duhet me e miratu. Masandej, me kthy, hapen debatet prap. Ka me u kthyer në Kuvend, anëtarët e Kuvendit kanë me qenë përfaqësues, dhe të gjitha të tjerat janë pjesë e procedurave ligjore që duhet me u rregullu. Ajo që duhet me u kry prej neve është që të dorëzojmë listat në mënyrë që mos me bllokuar proceset për shpejtimin e zhvillimit ekonomik apo thithjes së investimeve, qoftë nga diaspora, kompani vendore, rajonale, të huaja etj., të cilat kanë mundësi me bë zhvillimin ekonomik dhe me hapë vende të punës. Për shkak se forma private qel vende të punës, administrata nuk mund të punësojë gjithë popullatën, por vetëm përmes formës private: ekonomia, ndërmarrjet e vogla, start-up-et, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por edhe investitorët e mëdhenj, pse jo, nëse ka. Ne kemi ambicie të tjera, për shkak se ky Kuvend ka marrë vendime jo vetëm për zonën ekonomike Loto 1 në Budrik, atëherë ka marrë vendime edhe për Loto 2 në Sadovin. Por momentalisht, edhe pse kemi shpallë zonë me interes të veçant, atëherë çështja është në vendim të Kuvendit, i cili është valid. Atëherë në pronën që kemi pasë, pronë e AKP-së, e cila është e njëjtë AKP-ja apo qeveria aktuale, Jakupit po i drejtohem, i është dhënë për 99 vite. Ajo pronë, edhe ajo është e baballarëve tanë, e jonë, djersa jonë dhe e Kosovës. Ajo pronë jepet dhe ka të limituar sipërfaqen, por kjo nuk ka rëndësi, se është e barazvlefshme me sipërfaqet tona. Këto i jep për 99 vite, prandaj nuk po bën ajo përjashtim qeverisja që ti faktikisht i takon asaj partie, dmth po jep përditë për 99 vite. Unë e di si janë deklaruar në atë kohë, por sot, si po veprojnë, se unë në cilësinë e kryetarit të komunës më vijnë për çdo javë njoftimet se cilat parcela ipen për 99 vite, e pse atëherë ata po e japin pronën për 99 vite. Unë nuk kam qenë idhtar i 99 viteve, kam qenë idhtar i afatit të mesëm, por jo afatit të shkurtër, se për shkak afati i shkurtër nuk i nxit investitorë me ardh me investu, p.sh. 5-10 vite nuk ia vlen qiraja për investime. Por nuk kam qenë dhe për 99 vite, kam qenë i afatit të mesëm që i nxit investitorët, por natyrisht ka dhe një periudhë kohore që sjell reproduktim, dmth gjenerim të hyrave, gjenerim të punësimit dhe zhvillim ekonomik lokal. Për zonën ekonomike, unë e ndaj mendimin. Mendoj se Morava duhet me u kthyer në përparësi, për shkak se kemi pasë

me presidentin e OSBE-së një takim pardje, regjioni komplet, kryetarët e komunave për Moravën, rregullimin faktik prej fillimit deri në fund. Rivitalizimi i pjesës së komunës në territorin e Vitisë nuk e rregullon Moravën, për shkak se neve na pengon mosrivitalizimi i pjesës tjetër të shtratit, natyrisht na paraqet çdo pesë vite problematika dhe detyrim për me investu prap, por rregullimi i tersishëm i lumit Morava prej Vitisë deri në Kamenicë prej Gryp Moravës e rregullon plotësisht. Ne jemi duke u përpjekur me gjetë donator, me presidentin, i cili është përfaqësues i Zvicrës, kanë qenë shumë të interesuar për Moravën. Besoj që kemi me ia dalë, për shkak se këtë javë priten zhvillime të reja. Kjo kuptim i rregullimit të shtratit të lumit Morava me kthyer në përparsi dhe me i dhënë hapësirë dhe potenciale bujqësore dhe zonës ekonomike. Zona ekonomike është në vend të mirë, atë nuk mund ta lëmë në ujë, në vërshime apo në liqene, duhet me bë zhvillim ekonomik dhe investitor aty me ardh, duhet me i zgjeru krejt hapësirat që janë aty, me ia bashkangjitur në mënyrë që investitor i ri me ardh dhe me ju dhanë mundësi me ndërto fabrika dhe masa rrumbullaksuese për prodhim-përpunim. Për shkak se kjo është gjenerim dhe zhvillim ekonomik. Unë ju kisha thanë që kështu duhet me mendu edhe për Loton 2 për Sadovin. Kishim zgjidh çështje pronësore, juridike shumë atje që kishte problematika, ju kishim dhanë mundësi banorëve lokal, investitorëve, dhe mundësi rajonit, kompanive. E kemi afër autostradën, e kemi hekurudhën afër, aeroportin e Prishtinës dhe Shkupit, kishim pasë mundësi atje me zhvillu. Tash Kuvendi dhe qeveria komunale e Vitisë duhet me qenë në mënyrë që atë pronë komunës me rikthyer, komuna me zhvillu menjë plan rregullativ të mirë. Mos harroni, edhe për Budrik kemi pasë plan rregullativ të miratuar, prandaj ajo duhet me u respektuar në plotni, në mënyrë që me ju dhanë hapësirë, mundësi dhe potenciale ekonomike, regjionale dhe komunale, me u zhvilluar dhe potencialeve të mërgatës. Ky orientim nuk ka kthim, duhet me shku drejt ekonomisë së tregut, drejt investimeve, duhet me ju dhanë hapësirë, por me rregulla, siç e tha kryesuesi dhe drejtoresha dhe këshilltarja. Më pëlqej diskutimi që patë, vërtet ashtu duhet me qenë, me detyru atë që merr dhe është nën rregulla të përcaktuara proceduralisht që në afatin e duhur, në dinamikë, me investu. Për shkak se komisionet të cilat kanë vendosur, ata kanë temat e referencës për cilët lami ka konkuruar: bujqësore, përpunuese, efikasitet në energji etj. Tash për tash kjo është iniciale. Ne kemi kryer detyrimin tonë si qeverisje, nuk jemi duke ua imponuar ju me çdo kusht listën e pronave me miratu. Edhe p.sh. e Gërmovës, e cila është harruar, ka të interesuar në Gërmovë, nuk është imponim ju me votu me çdo kusht listën që ne jemi të detyruar me çuar tash. Nëse mendoni që ka të tjera, ose mendoni që duhet me hekë ndonjë, ose mendoni që keni të drejtë, ndoshta profesionalisht e keni pa që juridikisht nuk është në domenin tonë, nuk kemi të drejtë. Edhe një po ua them: nëse nuk kemi të drejtë dhe Kuvendi vendos që nuk kemi të drejtë, për shkak se nuk është pronë komunale, na kthejnë në rishqyrtim. Ne e shtojmë në rishqyrtim dhe e rregullojmë. Ky është fleksibiliteti që ne duhet me bë. Aspektin ligjor duhet me respektuar, rregullat në fuqi duhet me i respektuar, procedurën duhet me i respektuar, por ju vendosni. Pse kemi propozu si qeveri? Ne e kemi çuar në debat edhe jo formal edhe formal. Unë kam insistuar, është qeveria komplet. Unë kam insistuar me bisedu në mënyrë transparente, edhe sot po ju them juve: bisedoni në mënyrë transparente. Vetëm nëse kemi dobi me çuar listën, siç e kanë dorëzuar krejt komunat tjera, nëse kemi ndonjë dobi me çuar listën për pronën në shfrytëzim, që më së pari duhet me ia dergu Ministrisë, mandej me kthy në procedurën ligjore, atëherë ne e bëjmë këtë. Ne e kryejmë një detyrim tonin si ekzekutiv, i cili faktikisht na del përpara si detyrim.

znj.Majlinda Shabani: Përsëritje për të gjithë të pranishmit. Dua të ndërlidhem shkurt për me u pajtu me parafolësit sa i përket temës që është ngritë. Për mua personalisht, sjellja me nxitim e pronave publike pa një verifikim faktik dhe juridik e përbën një shkelje të rëndë ligjore, dmth një papërgjegjësi institucionale. Kryetarin e dëgjova me vëmendje dhe i përmendi disa prej arsyeve. Nëse qenkan me kaq interes për qytetarët e komunës së Vitisë, edhe nëse praktikat e mëhershme të dhënies së pronave në shfrytëzim na kanë dëshmu që këto prona që i kemi dhanë në shfrytëzim kanë prodhu rezultat me interes publik dhe qytetar, atëherë dilni dhe thuani cilat janë ato, se ne për besë nuk e dimë. Edhe nëse qenkan kaq shumë me rëndësi, është shumë e thjeshtë me arsyetu: bjeri arsyetimet në kuvend komunal kur e jepni një pronë në shfrytëzim, jepni arsye konkrete se për çka po ipet. Edhe investitori që e merr pronën në shfrytëzim paraprakisht duhet me kalu nëpër disa hapa konkret që atij me i taku prona publike, e jo secili investitor, secili person i caktum, muj me thanë, dhe të interesave të ngushta të kryetarit apo klientelave të tij, me pas qaq të lehtë me marrë një pronë publike në shfrytëzim pa e

paraqit një plan konkret afatgjatë. Po flasim për 99 vite. Ne ta paraqet zotnia një plan afatgjatë, me një plan konkret se çka ka me prodhu ajo pronë publike në momentin që ipet në shfrytëzim, me na tregu se çka po prodhojka. Qysh tha edhe kryetari, prodhon vende të punës; tha se ne nuk kemi mundësi me prodhu vende të punës. Jo, kryetari ka prodhu vende të punës tu i mbajtë njerëzit peng me kontrata të “Karitasit” dhe “Kosova Medit”, ne këtë e dimë. Edhe tash çka me bë? Po e lëshojmë listën për miratim, mandej po e kthejmë prap në kuvend për shfuqizim, se kjo është praktikë që është tu funksionu në komunë. Kur nuk ki planifikim afatgjatë, kur nuk e ki, dmth, verifikimin as faktik as juridik të pronave publike që i ke në komunë të Vitisë, natyrisht që ti duhesh me i përmbush ato kërkesat ligjore që duhet listën me dërgu, mandej na me i jap të dhënat tjera se çka, kur parashihet me ndërto diçka aty: a ka objekte, a ka rrugë, a ka shtëpi, a plotësohen kriteret me u bë ai investim. Nuk është veç hajt ta bëjmë, nuk funksionon kështu. Për besë, unë po habitem se si doni me ja bë kështu. Tregun e kafshëve e kemi qu pronën për mu votu, tani e tash ajo kur të ndërtohet, si doni me u kthi ajo mbrapa? Kur të niset një investim, po donë me bë hapa që mandej nuk ka kthim. Nuk jemi tu folë për diçka shumë të thjeshtë, është një problematikë. Edhe tu e pa që kërkesa e qytetarëve nuk ka qenë për atë vend, unë për besë po habitem. Del këtu e arsyeton me arsyetim të kotë, edhe çohet, del prej seancës, nuk i ngon këshilltarët komunalë. Është komplet një papërgjegjësi institucionale deri në fund.

Kryesuesi, Bekim Azizi: Majlinda, shumë thjesht po të them: kaniher, edhe pse nuk e ke të qartë, ti e din — ke qenë edhe një mandat. Kjo listë, prona e tillë që e përmende dhe te tregu i kafshëve, hyn në listën që mund të jepet në shfrytëzim. Nuk do të thotë që bëhet menjëherë treg i kafshëve, por do të thotë që ata që e kanë pasë në shfrytëzim që sa kohë, ti mundesh me lypë informata sa kanë pagu — është çështje tjetër. Atyne ju ka kalu tash afati që kanë pasë në shfrytëzim. Momentin që e ka kalu afatin që kanë pasë në shfrytëzim, tash hyn në listë, se pa hy në listë nuk mund të jepet në shfrytëzim. Në pjesën tjetër, komuna i identifikon pjesët e pronave komunale dhe i len përherë në listë, në faqe, që investitori që ka një interesim me ardhë me i gjetë dhe me konkuru me plan. Se ti e din që nuk mund të bëhet një komision për një pronë me u dhënë në shfrytëzim; për çdo pronë ka me fillu procedurë e veçantë, ka me u bë komision i veçantë prej kuvendit dhe prej ekzekutivit, dhe ajo pronë ka me u shqyrtu. Edhe vjet po vazhdon deri sa jepet në shfrytëzim. Edhe vjet, për me ja dhanë mundësinë të vetmes pronë si pronë e caktume, vjen në kuvend, ja japim mundësinë me fillu procedurën, e fillon komisioni. Kur komisioni i mbaron procedurat, atëherë vjen në kuvend dhe kuvendi e miraton, ja cakton afatin kohor. Në këtë formë shkon procedura për çdo pronë që jepet. Kjo është listë që përcaktohet që investitorët me pasë në faqe të komunës, që nëse kanë interesa të tilla. Dhe nuk mund të vijë jashtë planit zhvillimor, por në bazë të planit zhvillimor mundet me u orientu me bë një investim, nëse dmth ka interesa dhe i plotëson kushtet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Faleminderit shumë, kryesues. Edhe pse pjesën dërrmuese të përgjigjeve i ke dhënë, për shkak të përvojës që e ke në kuvend, që realisht është ashtu. Një prej këshilltareve e shtroi: cila është interesi i komunës? Gjithherë interesi i komunës në këto raste është vjelja e taksës, hapja e vendeve të punës dhe krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik, dhe pikërisht për këto bëhen edhe këto çështje. Një këshilltar e shtroi çështjen e destinimit, tha e ki shumicën e rasteve pylltari “Lab”. Në këtë destinim, në aparatën kadastral apo në bazën e të dhënave është e regjistruar kjo saktësi. Mund të ndodhë që është e regjistruar si pyll për shkak se kjo gjendje është bartë prej ish-Jugosllavisë; ndoshta realisht nuk i ke 10–15 drunj, e është kullosë, por e regjistruar është si e tillë. Prandaj këto nuk mundet me i ik kësaj baze. Tregun e kafshëve e tregoi kryesuesi: bëhet fjalë për tregun e kafshëve ekzistues, të cilëve ju ka kalu kontrata, dhe tash duhesh me e shti në listë për me ja dhënë dikujt tjetër — nuk ke shans tjetër. Është e vonume lista për shkak të zgjedhjeve. Gjithherë ju e dini, këshilltarë që jeni me përvojë, që është 31 dhjetori; për kësaj radhe ministria e ka shty për 3 muaj, se e ka pas parasysh edhe këtë çështje. Gabimet më fatale të cilat unë i hasa janë kur thonë: po i shtini pronat pa verifikim faktik dhe juridik. Unë nuk e di si e kuptoni këtë verifikimin faktik dhe juridik. Ne këtu nuk ka pronë që nuk e kemi prur me ekstrakt të certifikatës dhe që nuk e kemi prur edhe kopjen e planit. Në rast se ti ke probleme në terminologji dhe nuk e kupton cili është ai verifikim, në propozim-vendim e ki të bashkangjitur me kopje të planit dhe me fletën poseduese. U tha që pronën ja keni dhënë KEDS-it dhe ende KEDS-i nuk e ka vendos trafon. Detyrë e jona është me ja dhënë pronën në përputhje me kërkesën e qytetarëve dhe të kompanisë.

Dhe në fund, unë e di që ju keni me qenë ata që e jepni në shfrytëzim pronën komunale — ju e formoni komisionin vlerësues.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë e kam pas një kërkesë tek drejtoresha, që me pas me shumë prona publike, që të ju lëmi investitorëve që të kenë më shumë. Edhe ne sot që e kemi ne tu e diskutu, nuk jemi tu e dhënë në shfrytëzim, jemi tu ja dhanë mundësinë kushdo që me apliku me e marr pronën e vitin e kalum. Kjo pikë ka kalu pa problem. Edhe grupi i LVV-së e ka kalu këtë pikë.

z.Labinot Bislimi: Kryesues, së pari deshta që me ja lan drejtoreshës me i bë këto shpjegime, se për atë punë është. E kam parasysh që ti ki përvojë edhe i din këto, ama mirë kish me qenë me e lan drejtoreshën me i shpjegu, dhe ju takon atyre me i shpjegu këto gjëra. Nuk besoj që është mirë me ja marrë fjalën ose pozitën e tyre në këtë rast. Te çështja e procedurës, se ne po e kthejm shpesh në procedurë — nënkryetari e ka zanat, gjithmonë e sjell punën te procedura. Nuk e kemi hallin vetëm te procedura, është çështje e përmbajtjes, sepse përmes këtyre pronave që jepen në shfrytëzim, faktikisht ndodhin edhe politikat ekonomike të Komunës. E ne e kemi hallin te politikat ekonomike. Kur të themi te politikat ekonomike, aty përfshihen të gjitha. Në qoftë se nënkryetari e tha që aty mundet me qenë parcela ku është e shkruar në kohë të Jugosllavisë si pyje, po sot janë 2–3 drunj, atëherë unë e shtroj pyetjen: pse ato mos me u bë prap pyllë? Sepse ne kemi nevojë për me rimbjell ose me rihvillu pylltarinë. Pse duhet ato të shndërrohen në diçka tjetër? E tha kryetari dhe iku, por nuk mundet me i ik përgjegjësishë, e sidomos në qoftë se e merr fjalën, ai duhet me ju përgjigj pyetjeve tona. Kur e përmendi referencën, unë dashta me pyet kryetarin: për cilën referencë e ka fjalën? Për kodin tarifor? Në qoftë se është për këtë, sepse këtu ka për aplikim për me zhvillu prodhimtari, tregti, d.m.th të gjitha këto e kanë një kod tarifor. Në qoftë se ka kod tarifor, unë du me ditë: si po e bëni mend ju, a ka me të vërtet mundësi që nesër këto kompani apo këta njerëz e kanë mundësinë me zhvillu një prodhim i cili pranohet prej ministrive të ndryshme përmes atij kodi tarifor, apo referencës siç e quajti kryetari? Unë dyshoj fort në këtë aspekt. Prandaj ne i kemi 100 pyetje dhe prandaj na duhet shumë më shumë me pa. Unë mendoj që drejtoresha në fjalë, por edhe krejt komuna, duhet me qenë shumë më e angazhuar pranë kompanive apo pranë investitorëve për me mujtë me i tërheq nëpër këto parcela. Kur po e kthejm në çështje procedurale, po më duket po na hup komplet ky aspekt, ose po mundohemi me fsheh: hajde ta kryjmë një procedurë, ta votojmë listën në fjalë, edhe çka bëhet me ato shfrytëzime... E thatë: ka me i mbledh komisioni. Bile, nënkryetar, e thatë “keni me vendos ju” — nuk është e vërtetë. Ne e dimë si funksionon ajo punë e komisioneve dhe e këtyre gjërave; nuk kemi me vendos ne, ka me vendos kryetari. Ato janë formale, nënkryetar. E di si funksionojnë, se në Komunë të Vitisë jemi, këtu jemi. I kam pa, e kam lexu edhe dokumentacionin tuaj gjatë gjithë kohës, nuk jam tu fol veç në ajër. Prandaj mendoj se kjo çështja e dhënies së parcelave duhet me pasë një diskutim shumë më të thellë përmbajtësor në nivel të opinionit publik, që ne si këshilltarë komunalë duhet me qenë më pjesëmarrës, jo ju me u mundu me shu debatin me një listë, të cilën e arsyetoni që ka qenë puna e zgjedhjeve etj., dhe ta kalojmë sa më shpejt e ta votojmë. Illir, besoj që jam nxitës i debatit, por nuk është çështja debat për debat, polemikë për polemikë. Këto çështje janë shumë serioze dhe besoj që, në qoftë se prek ndërgjegjen jo vetëm të opozitës, por duhet ta prek ndërgjegjen e çdo secilit këshilltar, sepse në fund të fundit përfaqësues të qytetarëve jemi.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Lab, kur e përmend aspektin procedural, kurrë anëtar i komisionit për dhënie në shfrytëzim nuk kam qenë, se nuk kam qenë këshilltar i Kuvendit Komunal, dhe gjithherë ka shku prej ekzekutivës dhe prej anëtarëve të Kuvendit Komunal. Veç një çështje e di: te thirrja, vetë dalja në ankand publik nuk e privon askënd mos me konkuru, të gjithë kanë të drejtë me konkuru. Kush duhet ta marrë pronën në shfrytëzim? E di që edhe këshilltarët që kanë qenë, gjithherë grupe mikse, ia kanë dhënë personit i cili i ka ofru komunës më së shumti, d.m.th ka ofru qira më të lartë dhe ka pas elaborat të punësimit më të madh. Tash, sa ka mujtë me realizu, ajo është tjetër çështje. Ajo që kemi mujtë, që ka qenë propozim i imi në koordinim të plotë me këtë kryesuesin që e keni sot këtu, kemi thanë që kemi me ja afatizu, se veç po e merr dhe... Ka 2–3 raste që ju ka kalu koha dhe ja kemi marrë. D.m.th nuk kemi qenë ata që pronën e kemi konsideru si të huaj, por e kemi konsideru si të shenjtë. Në hapa procedural, ai nuk e ka fillu afatin, varësisht nga komisioni sa ja ka dhënë për me fillu punën. Edhe kjo është aspekti procedural, detyrë e jonja dhe e juvja.

z.Jakup Demiri: Kryesuese, është mirë me ba një standard për të gjithë. E ke një vërejtje nga ana ime, se ata nga ekzekutiva janë si me qenë baba këtu, kur dojnë e marrin fjalën dhe dalin prej teme krejt. Me Ilirin e kam një polemikë; pikërisht vitin e kaluar ka qenë Ramazan kur është trajtu kjo listë, edhe e din mirë ti, Ilir, çfarë polemike kam pas me nënkryetarin në KPF. E din edhe çfarë termi mu ka drejtu nënkryetari, e kur ka ardh në mbledhje të Kuvendit ka thanë “pate të drejtë”, ama nuk më ka kërku falje. Komisionet janë formale, nuk i pyet kërkush. Nëse këtu kalon ky document, e që kalon, se janë koalicionet, është normale që kalon. Te puna e parcelave, edhe një herë po e themë: është mirë me i diskutu këto parcela. Është kërkesë e imja me u përcaktu më mirë. Po kërkoj sqarim për destinimin: prona e cekur jepet në shfrytëzim për destinim bujqësor, pyje pyjore, bujqësore, zona 5; prona e cekur jepet në shfrytëzim për destinim për tregun e kafshëve; tjetra zonë industriale. Po sa janë të përcaktuara për shfrytëzim afatshkurtër? Unë e di që nja tri janë për panele solare këtu, po nuk është e cekur këtu për këtë veprimtari.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Në momentin që është aprovu plani zhvillimor komunal nga ju këshilltar të Kuvendit Komunal, duhesh me pas të kjo që nëse nuk është i parapam me plan zhvillimor komunal, ti me be diçka tjetër. Kurrë!

zn.Majlinda Ostergllavas, drejtoreshë: Këto prona komunale nuk janë tu u dhënë në pronësi, po në shfrytëzim afatshkur ose afatgjatë, që është interesi i Komunës.

z.Elham Emërllahu: Drejtoreshë, se çka dojmë ne është çështje e jona me kërku sqarime për pikën e rendit, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme. E para, është e arsyeshme diskutimi i asamblistëve; ne po kërkojmë sqarime. Me nënkryetarin nuk po muj me u pajtu këto dy-tri seanca, sepse po hyn në vlerësime personale. Seancën e kalume ke vlerësu për mu, sot për kolegen, s’e di pse. Në seancën e kalume ke vlerësu për mu, tash vlerësive për kolegë të tjerë. Ne nuk jemi krejt juristë, por i kemi dokumentet përpara. Tash, përderisa vjen, sepse qat pikën ku duhet asamblistët me diskutu na e keni qitë si pikë të fundit të rendit të ditës, edhe ne e kemi të nevojshme dhe të arsyeshme. Nuk jemi kundër diçkaje, veç po lypim sqarime. Unë thash në fillim: cili është interesi i komunës dhe për çka është e destinuar, asgjë tjetër. Por mos të hymë në vlerësime personale dhe me u mundu me e stopu debatin e asamblistëve.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kam thanë: mbledhja e taksës është interesi, hapja e vendeve të punës dhe zhvillimi ekonomik. Këtë pyetje e ke bërë, këtë përgjigje e ke marrë. Në rast se mua më thuhet, ose dikush prej këshilltarëve thotë se nuk është bërë verifikim faktik dhe juridik, unë e kuptoj se çka është verifikimi faktik dhe juridik. Verifikimi juridik është kjo: që ta ka sjellë këtu, që tregon se në rast se prej kësaj ke dëshmi që ne të kemi mashtru — nuk është titullar Komuna e Vitisë, nuk është pronë e komunës — atëherë unë marr përgjegjësi së bashku me drejtoreshën dhe ekipin. Ti i nderuar ke një seancë, por puna e këshilltarit komunal është 30 ditë. Nëse gjatë këtyre ditëve keni kërkuar takim me mua ose me kryetarin dhe nuk ju kemi dhënë përgjigje, atëherë trego që kjo nuk ndodh kurrë. Unë e di që krejt juristët dhe krejt nuk e kuptojnë, dhe është e drejtë me kërkuar sqarime për të gjitha.

z.Basri Aliu: Sa po e shof unë, po e ulim debatin në këtë Kuvend dhe nuk jam i interesuar në këtë formë të diskutimeve. Ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe duhet me paraqit një edukatë në diskutim. E kuptoj mendimin kundër ose mos-pajtimin, është shumë normale, por duhet ta kuptoni edhe këtë: se për seanca diskutohet me argumente, jo vetëm me llafe koti. Këtu po ceket “koalicion”, palidhje që nuk ka të bëjë hiç me rendin e ditës. Unë po tregoj që koalicioni është bërë me lidhje, jo palidhje. Të gjitha këto prona që janë në këtë listë, si prona komunale për shfrytëzim, sikur ne që kemi dalë kandidat për asambleistë, njerëzit formojmë listën për secilën parti. Tash dalim për me u verifiku se kush do të fitojë, edhe këto do të sigurohen prap që të vijë te ne dhe të shihen. Ne kemi me i propozu më së pari komisionit, që edhe prej kuvendit kanë ata që do të verifikojnë, edhe këto pjesë, ofertat që do të vijnë prej operatorëve. E shohim atë, për sa vite e japim. Ne këtu nuk kemi çka të diskutojmë, sepse është një listë e cila duhet me shku me u aprovu, e mandej për secilën pikë veç e veç mundemi me diskutuar dhe ma qartë në këtë. Jakupi nuk qenka këtu, por Jakupi këtë pikë të rendit të ditës e ka aprovu në KPF, prandaj nuk e di pse vazhdojnë këto diskutime.

z.Ilir Zuka: Atë që deshta me thanë e tha Basria. Ne këtë e kemi kalu në KPF, e kemi kalu dhe vitin e kalum. Para 2 seancave ka qenë një kërkesë, pse nuk na kanë ardh pronat për votim, dhe në mënyrën më të sinqert më

kujtohet që Jakupi i ka thënë është procedurë, për shkak të zgjedhjeve që është vonu, nuk u diskutu asnjëherë që këto prona mos me i kalu në KPF. E kalum pa diskutim. Unë i kuptoj asamblastët e PDK-së, se është hera parë, mirëpo në kemi kalu 4 vite dhe 8 vite si asistent i kryesuesit, këto janë procedura që duhet me u ndejk dhe nuk ka asgjë tjetër. Dhe diçka të tregu, d.m.th tregu është që 10 vite aty, d.m.th veç i ka kalu afati, veç me vazhdu.

znj.Majlinda Shabani: Dua të nderlidhem te nënkryetari: ta keni një gjë të qartë, nuk kam nevojë me më dhanë shpjegime për terminologji që unë i përdor në seancë, e as nuk kemi nevojë me na dhanë përgjigje për çështje administrative në këtë rast, siç po jepet prej kryesuesit në diskutim. Shumë qartë: nëse ju e keni problem me me kuptu neve dhe për me arsyetu atë që po thojmë, është problemi juaj, nuk është problem jonë. E dimë që pronat duhet me shku në listë. Hallin dhe dertin e kemi kujt po i shkojnë ato prona, si po jepen ato prona. Drejtoresha i thotë 2–3 fjali, thotë “nuk jemi tu ia dhanë pronën për gjithë”. Jo, nëse ja jep për 99 vite, ti je duke fol për pronën, nuk është në rregull. Siç e keni marrë kuvendin në këtë formë, madje dhe diskutimi po tregon që po ulet niveli i diskutimit. Po thoni: “qoftë po fol, qoftë mos fol”, mirë, por në jemi këtu si këshilltar komunal dhe nuk ka nevojë me u kthye në metafora. Çështja e diskutimit që po bëhet këtu nuk është në rregull fare. Nuk ka nevojë me më dhanë fare arsyetime administrativ. Jepni arsyetimin: pse jepet një pronë në shfrytëzim, si ka me u dhënë, a plotësohen kriteret apo jo, dhe atëherë jemi në rregull. Kaq e thjeshtë, kaq e qartë. Nëse keni problem me arsyetu këtë, mandej në jemi këtu për me repliku, por nuk mundeni me na tregu kur me repliku, kur mos me repliku, çka me fol dhe çka mos me fol.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po tregoj të drejtën: nuk e di përgjigjen më të saktë për shkak të çka jepet, kur e shtroni, kërkoni në rast se doni shtesë për herë të tretë. Interesi i komunës gjithmonë është vjelja e taksës administrative, punësimi i qytetarëve dhe zhvillimi ekonomik. Kur jepet prona, janë këto çështje. Kjo është hera e tretë që po e themi. Në rast se ti nuk je e bindur edhe me këto, thuaj: “Unë nuk jam e kënaqur me këto, po kërkoi diçka tjetër.” Kam qenë kujdestar i mirë i pronës komunale. Momentin e lidhjes së kontratës gjithmonë kemi kushtëzuar: për herë të parë kemi bërë si standard. Kemi thënë: nëse brenda 1 viti nuk fillon dhe brenda 3 viteve nuk e përfundon pronën, ja marrim. Ai që ka paguar për atë kohë obligimet që ka pas për komunën, ja kemi shkëput kontratën. Tjetra që është me rëndësi: 2 anëtarët e komisionit shkojnë prej ekzekutivës, 2 prej kuvendit komunal dhe 1 prej shoqërisë civile. Ky komision është miks. Këto janë procedurat dhe rregullat.

z.Labinot Bislimi: Nënkryetar, ndonjëherë na duket vetja sikur jemi para Zyrës Ligjore e jo para nënkryetarit. Për të qenë të qartë: në aspektin juridik dhe të terminologjisë juridike nuk kemi problem, këto aspekte procedurale i kuptojmë. Majlinda e tha dhe po e themë edhe unë, por ajo që po mungon është se, në duhet me pas përher më të qartë politikat ekonomike dhe zhvillimore që ju jeni duke i ndjekur. Këto nuk janë procedura, nuk janë formalitete, dhe nuk mundeni me i thirrë nëpër dokumente si plani zhvillimor komunal etj., sepse ato janë forma, jo përmbajtje. Unë mendoj që drejtoria në fjalë dhe ju, bashkë me ta, sepse nuk ju kemi thirrë për Zyrë Ligjore, keni kapacitete për këtë punë: me na qartësuar politikat që jeni duke i ndjekur lidhur me shpërndarjen dhe shfrytëzimin e pronave publike. Kjo është çështja, që të mos ngatërrohemi këtu, por të mos e ulim nivelin më poshtë apo ta sjellim vetëm në aspekte ligjore, procedurale dhe juridike.

z.Jakup Demiri: Ilir, ajo dëshmon se unë ta kam thanë: pronat janë shtyrë për shkak të zgjedhjeve, dhe kjo tregon që kemi informatë, e dimë si shkon kjo punë. Sa për kolegun Basriun: është e vërtetë që në votojmë, nuk jemi kundër këtyre gjërave, por duam me zgjedh më të mirën, kjo është puna jonë. Nënkryetari tha që kemi filluar me disa që kanë marrë ato prona dhe nuk kanë bërë investime; ne i kemi shqyrtuar. Nuk di nëse i kanë marrë realisht, por kjo ka qenë tendenca jonë që ta shtyjmë. Ka pasur efekte dhe ka efekte, kjo është puna jonë që duam me bë. I pëlqen apo jo dikujt, është muhabet tjetër, por për diçka që nëse ka pengesa, nuk ka. Për këtë që thua nënkryetar: kur formohet komisioni, një është prej neve aty — çka qonë peshë, është i papërfillshëm.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jakup, jan 2 raste, se the nuk i di. Nja është në Letnicë dhe një në Visoq, ndoshta ka dhe të tjera, por dy po i di.

znj.Liridona Bislimi: Po e përsëris prapë: keq që nuk kemi media televizive që ta transmetojë këtë temë, sepse ky diskutim është kaq i rëndësishëm, direkt për qytetarët tanë. Për shkak se prap se prap në jemi pasqyrimi

i kërkesave të tyre, e rëndësishme është se çka po diskutohet, si prej anës sonë, po ashtu edhe më e rëndësishme prej anës tuaj. U përmend që ky diskutim është hapur edhe në komitet. Të nderuar, ju na e keni mësuar këtë pikë: së pari, në komitet ka veç rekomandim. Ti nuk mundesh me ndalu që të vijë këtu sa do që ke kërkesa apo diskutime ndryshe. Kemi pasë raste që nuk kanë kaluar në komitet, por prap kanë ardhur këtu, për shkak se ju e keni cilsuar si rekomandim. Pra, kjo formë nuk do të thotë që KPF ka fuqi për të ndaluar diçka. Çështja tjetër: bëhet një diskutim prej një anëtari të një subjekti të koalicionit. Në thelb, është i njëjti shqetësim, i njëjti përpunim, dhe i njëjti vlerësim. Më pëlqen ky diskutim, sepse në anën tjetër për neve, është vlerësim që nuk po e dini çka po flisni, nuk po i kuptoni termat juridikë etj. Të nderuar nënkryetar, unë nuk përmenda asgjë në aspektin juridik; gjithçka thashë është në aspektin faktik. Nëse ti një pronë tënde private ia jep dikujt në shfrytëzim, dhe ai e merr, po nuk e di çka po bëhet për të, tash ti je gabim. Unë e përsërita këtë për KEDS: d.m.th për 1 vit ne kemi dalë para banorëve të Drobeshit dhe kemi thënë: “e kemi kryer punën, prona është marrë, po ku është trafoni?” Edhe në mandatin e kaluar, votata në Drobesh, sidomos te lagjja e Ballancave, takimin kryesor e ka pasur me raport për trafoni, premtim kryesor elektoral. Amni votat prap, iu dhanë: tash ku është ajo pjesë? Unë e di, ju do të thoni që KEDS është kompani private, po në qoftë se i ke dhënë atë pronë në shfrytëzim, cila është përfundimisht rezultati i asaj prone që po jepet? Kolegu Ilir e përmendi: pjesa e parcelës në Germovë, ne e kemi pas edhe herën e kaluar për të dhënë në shfrytëzim. E di Iliri si ka reaguar kur ka qenë destinimi për planifikim, se çka mund të ndërtohej. Për ne, në Pozharan, e kemi mbështetur, sepse krejt në KPF kemi parë informacion tjetër dhe kur e kemi marrë, e kemi analizuar dhe kuptuar se është krejt diçka tjetër — dhe nuk e kemi lejuar as të ndërtohet në Pozharan, as në Germovë. Kjo është përfundimisht: ajo që ne jemi duke e kërkuar është sqarim për të ditur çka po bëhet dhe në fund të javës, me shpjegu qytetarëve se çka jemi duke bërë ne.

z.Basri Aliu: Për ne, në KPF u diskutua edhe kjo çështje dhe anëtarët që kanë qenë aty kanë pasur mundësi t'i shprehin shqetësimet e tyre. Lidhur me parcelën në Drobesh dhe dhënien e saj KEDS-it për trafoni, pasi kam qenë vetë aktor në atë proces, dua të jap një sqarim: parcela iu dha me motivacionin që KEDS kishte bërë kërkesë tek komuna për të liruar hapësirën, në mënyrë që ata të kishin mundësi të investonin. Qëllimi ynë ka qenë që të mos pengojmë këtë proces. Për këtë arsye, atëherë ia dhatë parcelën, në mënyrë që nesër të mos thonë se nuk ua kemi dhënë dhe nuk mund të investojnë. Ne kemi bërë të gjitha përpjekjet që procesi të ecë sa më shpejt, që të mos krijohen pengesa. Për rëndësi, parcela është KEDS-it, dhe tashmë investimet e tyre janë parashikuar dhe shpresojmë që do të realizohen sipas planit.

z.Bekim Azizi kryesues i kuvendit: E qes ne votim per miratim këtë pikë të rendit të ditës. A jeni që të miratoht lista e pronave për dhënie në shfrytëzim me plotësimin edhe te pronës që u prezentu në Germovë. Kush është pro? Me 17 vota për, kundër nuk ka, abstenim 8, miratohet kjo pikë.

Pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Është fjala për një pronë e cila ka fillu qe 2 vite me u dhanë në shfrytëzim, është pronë e listave që permenden. Janë pak mbi 3 ari nëse nuk gaboj, është në material. Kjo kërkohet prej disa familjeve që kërkohen për hapje të bunarëve, që nuk kanë ujë. Një pjesë është përdorur që nuk ka ujë, mirëpo kjo pjesë ky nuk e ka bërë pa leje të Komunës, është tu prit mbi 1 vit, komisioni ka qenë i formuar, por sun e ka kry punën, se me mbarimin e mandatit mbaron dhe i komisioni, dhe e njëjta pikë është përsërit për Kuvend Komunal. Kërkohet formimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim për dhënien e kësaj parcele.

z.Labinot Bislimi: Nëse është fjala për një pronë në Tërpezë për shfrytëzimin e ujit, d.m.th për bunar, unë kam marrë ankesa prej qytetarëve ose banorëve të asaj ane, të cilët gjithashtu nuk kanë ujë, të cilët nuk i lënë me shfrytëzu po atë pus të ujit, dhe unë mendoj që, në qoftëse i jepet në shfrytëzim kjo parcelë, ku është dhe çështja e ujit në atë pjesë, nuk mendoj që ajo duhet të personalizohet dhe të mos i jepet akses në atë pus të ujit edhe banorëve të tjerë. Dua ta di sakt se si do të jepet kjo parcelë, në çfarë kushte, dhe mendoj

që komuna me të vërtetë duhet të vendos kritere që mos t'i ndalohet ose mos t'i ndërpritet mundësia banorëve të tjerë për ta shfrytëzuar atë pus, dhe mendoj që kjo kërkesë duhet të merret seriozisht.

z. Ilir Zuka: Qysh tha dhe Labinoti, edhe unë jam i informuar për këtë rast. E njof atë djalin edhe personalisht, punun në QKMF në Pozheran, dhe jan tu hjek si familje jashtëzakonisht shumë me ujë. D.m.th kanë kalu mbi 20 vite ata ende bartin ujë për shtëpi. Në atë pjesë ka shumë puse që janë hap pa leje të Komunës në pronë publike, mirëpo ai ka thënë do të vazhdoj të barti ujë me vite të tëra, nuk e shfrytëzoj një pronë nëse nuk më lejohet prej Komunës. Unë personalisht jam pro me ja mundesu që të ketë ujë si çdo familje.

z. Labinot Bislimi: Është e drejtë themelore e drejtave të njeriut në kartën e Kombeve të Bashkuara, kjo e drejtë nuk mundet me ju refuzu një qytetari në akses për ujë, duhet ta keni parasysh.

z. Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Mua më vjen keq për atë qytetar që vitin e kaluar u përfshi në proceset zgjedhore dhe u ndalua nga procedura që ka qenë për dhënien e pronës, dhe për këtë arsye kjo pronë ka hyrë përsëri në listë. Tash duhet të formohet komisioni. Në plotni pajtoj që duhet të caktohen kriteret për dhënien e një prone në shfrytëzim nga ky komision që po kërkojmë të formohet sot. Komisioni duhet t'i përcaktojë kriteret mbi dhënien në shfrytëzim. Në rast se i jepet dikujt, komisioni gjithsesi mund të refuzojë, por duhet të ketë kritere të qarta të dhënies. Kërkesa e qytetarit është bërë, por pjesëmarrja në ankand publik nuk do të thotë që dikush tjetër nuk mund të konkurrojë dhe ta marrë pronën, nëse ofron kushte më të mira. Megjithatë, unë konsideroj që duhet të formohet komisioni për t'i shqyrtuar mundësitë dhe për të përcaktuar se cili është opsioni më i mirë, që nuk e shkel ligjin dhe njëkohësisht i plotëson nevojat e qytetarit.

z. Labinot Bislimi: Unë nuk e kam informatën e njëjtë lidhur me rastin; ai nuk u tërhoq prej kërkesave dhe procedurave dhe ka bërë rregullisht thirrje. Duhet të jetë kërkesë e këshilltarëve komunalë që komisioni ta marrë parasysh kërkesën tonë si kriter të domosdoshëm për t'u dhënë shfrytëzimi i pronës, sepse këtu kemi të bëjmë me një të drejtë elementare: uji nuk mund t'i refuzohet askujt. Nuk mendoj që kjo është çështje e lehtë, sepse besoj që ka konflikt interesi mes qytetarëve atje, mirëpo komuna dhe këshilltarët komunalë duhet ta drejtojnë në mënyrë që çdo qytetar të ketë akses në pika të ujit, kudo që janë, sidomos në këtë rast.

z. Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E ke keqkuptu, ai nuk është tërhequr nga kërkesa, por në 6-mujorin e fundit, MAPL me kryeministrin kanë dërguar një shkresë, ku disa të drejta që i ushtron komuna, në këtë rast edhe Kuvendi Komunal, i pezullohen për 6 muajt e fundit para zgjedhjeve. Kjo ka qenë arsyeja pse e kemi tërhequr ne, jo kërkesën e tij.

z. Basri Aliu: Për rastin që po diskutohet, unë personalisht e njoh, sepse ka qenë dhe ka bërë kërkesë kur isha drejtor i Shërbimeve Publike, që t'ia mundësojmë një gjë të tillë. Por sipas rregullave dhe ligjeve, nuk e kemi pasur ne si drejtori që të japim në shfrytëzim pronë komunale, përveç siç është në rregullore – për 1 vit. Ne e kemi orientuar në mënyrën tjetër, që ai të veprojë dhe ta realizojë qëllimin e tij, e cila, si tha Labinoti, është një e drejtë elementare që t'i mundësohet. Ai nuk ka dashur që jashtë rregullave të dalë, sikur të tjerët që kanë hapur puse në prona komunale pa dijeni të komunës; ai nuk ka dashur me e bë këtë veprim, por ka vepruar sipas rregullave.

z. Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Nga ekzekutivi është propozu komisioni: Fatmir Salihu, Fitim Selmani, nga shoqëria civile Shyqeri Halabaku. Kisha kërkuar 2 propozime nga Kuvendi, një prej pozitës, një prej opozitës.

z. Basri Aliu: Ne si grup i LDK-së propozojmë, Faruk Shabanin.

z. Jakup Demiri: Ne si grup i VV-së propozojmë, Labinot Bislimin.

z. Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: A jeni që të miratohet komisioni? Pra, me 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim, miratohet komisioni.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë

z.Bekim Azizi kryesues i kuvendit: E dini që kemi dhënë autorizimin në seancat e kaluara kryetarit të komunës për marrëveshje me komuna të tilla dhe, në bazë të autorizimit që ka pas, tash ka pru një marrëveshje për binjakëzim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E kanë pa të dy komunat se në cilat fusha munden me punu dhe e kanë parapa një pjesë prej asaj në sport, kulturë, në gjuhë, bujqësi, kulturë, ekonomi, që duhet të jenë bashkëpunuese mes vete dhe e shoh si gjë të mirë këtë marrëveshje mes dy komunave. Një pjesë bukur e mirë e shqiptarëve jetojnë dhe veprojnë në atë pjesë dhe për atë duhet të lejohet një çështje e tillë.

z.Labinot Bislimi: Unë çdo binjakëzim që bëhet me komuna nëpër botë e shoh si gjë pozitive, por ajo që më pengon te komuna e Saint Julien, të cilën e njoh mjaft mirë, është se pak a shumë është e dimensionit të komunës sonë dhe është një diçka që, në një dimension të caktum, nuk jemi të barabartë me komunën e Saint Julien. Kryetari i komunës e ka një zyrë tepër të madhe krahasuar me kryetarin e komunës së Saint Julien dhe mendoj që në këtë aspekt është dashtë me bë binjakëzim me Parisin, jo me Saint Julien. Kjo është ajo defekti që, sinqerisht, unë nuk e shoh si mundësi një binjakëzim të tillë dhe votoj kundër, sepse nuk jemi në dimensione të barabarta. Po e them me sinqeritet: kryetari jonë ka zyrë sikur me qenë guvernatori i New Yorkut, jo i komunës së Vitisë. Dhe e dyta, kam frikë se aty në marrëveshjen që keni bë është dashtë me futë edhe një nen, në të cilin me thanë që së paku mos me pasë binjakëzim të korrupsionit, krimeve ekonomike dhe shumë çmendurive që ndodhin në komunën tonë e që nuk ndodhin në komunën e Saint Julien, se kur t'ju tregoni ju se si e keni bë zonën industriale, ata kanë me u çudit. Duhet ta kemi një siguresë që mos t'ua kalojmë disa gjëra, por ta kemi mundësinë që të marrim diçka të mençur prej tyre.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Lab, shumë ke me u sillë rreth programit tanë, por duhesh me harru atë program se ka hupë, ka përfundu në momentin e votimit; nuk ka shku. Tash përgatitesh për zgjedhje pas 4 viteve. Megjithatë, unë nuk kam qenë, Lab, në Saint Julien, në zyrë të kryetarit apo kryetares, por më vijnë informacione se zyrën e paska më të madhe se të kryetarit tonë, nga njerëzit të cilët kanë qenë. Dhe zyra ku qëndron sot Sokol Haliti nuk është e tij, është e kryetarëve që vijnë pas tij, dhe ti në vend se me falënderu që është rregullu ajo zyrë dhe i mirëpret kryetarët të cilët e fitojnë mandatin. Unë konsideroj që ne si komunë e Vitisë mundemi me përfitu prej tyre, por edhe gjithë komunat në Kosovë, sepse jemi shtet i dalë prej luftës dhe janë para neve si në aspekt administrativ, zhvillim ekonomik, kulturor e të gjitha të tjerat. Unë personalisht e shoh të dobishme, në veçanti kur kam pa shumë të rinj dhe të reja të komunitetit shqiptar të cilët merren edhe me sport, që munden me të dhënë diçka. Ata kanë pas një vizitë te klubi i futbollit Vllaznia etj., dhe unë besoj që është e mirë për komunën e Vitisë.

z.Labinot Bislimi: Nënkryetar, komunën e Saint Julien po e ngatërron me Marie, që është objekti i komunës me zyrën e kryetarit, besoj. Shko vizitaje, do të jetë sa zyra e kryetarit; kryetari ka objekt në vete, jo zyre. Plus asaj, ai objekt ka qenë i partive politike më përpara, sa vite kam sa me mbajt mend — në atë objekt kam hy e kam dalë shumë herë. Në qoftë se në të ardhmen e paske bë mend ose kryetari e ka bë mend me na lanë këtë trashëgimi neve që do të jemi kryetar të ardhshëm, kushdo që të jetë, atëherë besoj që nuk është trashëgimia e duhur. Unë besoj që ai është dashtë me na lanë trashëgimi tjetër: reforma në arsim, probleme të cilat nuk është dashtë me shkaktu, ujësjellësi me pasë të rregullum, ujin e pijshëm. 90% e shkollave sot në Komunën e Vitisë nuk kanë ujë të pijshëm. Kjo është trashëgimia që duhet me na lanë kryetari, jo zyra e vet. Zyra e tij nuk është vlerë, këtë ta garantoj.

z.Bekim Azizi kryesues i kuvendit: Faleminderit për debatin! A jeni që të miratohet kjo marrëveshje? Kërkoj votimin tuaj. Pra, me 22 pro, 0 kunder, 0 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Pra, shkojmë në pauzë, në ora 1 vazhdojm me punimet.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Përshendetje te nderuar te pranishëm vazhdojm me pjese e dyte te seancës se kuvendit

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m², në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jete parcela nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m²**

Siç e dini, këtë pikë në seancën e kalume e kemi votu, po MAPL- ja naj ka kthy si jo të ligjshme, prandaj do ta shfuqizoj.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Faleminderi kryesues i seancës, të nderuar këshilltar. U kthu vendimi si jo ligjor, për shkak se, vendi në të cilin është i paraparë për çerdhe, nuk është vendi që e kemi propozu ne, po është vendi ku është ish ndërtesa e zyrës së vendit, që ka qenë. Përkisht për këtë ka thanë: në përputhje me plani zhvillimor komunal bine vendimin. Dhe ne e kemi bënë një ndryshim, po nuk na kanë leju. Jemi obligativ me e shfuqizu, e në seancën e radhës do ta keni vendimin në përputhje me planin zhvillimor komunal.

z.Labinot Bislimi: Siç u diskutu edhe herën e fundit, është çështja më serioze në këto vitet e fundit, sepse është e lidhur direkt me sistemin edukativo-arsimor. Të nderuar asamblistë, së pari dua t'jua përkujtoj se, para se të mendoni për veten si pjesë të një subjekti politik, duhet ta mendoni veten si përfaqësues të interesit të përgjithshëm dhe të interesit qytetar. E di, pra jam i vetëdijshëm për rolin e partive politike, e kuptoj varësinë që kemi prej tyre, megjithatë, veçmas në nivelin lokal, ju nuk e keni asnjë obligim ligjor apo etik ndaj tyre. Andaj, kur vihet në pyetje interesi i përgjithshëm, ju e keni obligim ligjor e etik ta mbronit atë me të gjitha kapacitetet tuaja. Po unë, gjithashtu bashkë me ju në këtë pikë, dua t'jua përkujtoj se çështja e çerdheve dhe mbarë sistemi edukativo-arsimor në Viti është në një udhëkryq serioz. Pra, vetëm ata që duan me i mbyll sytë e injorojnë këtë çështje, apo nuk duan t'ia dinë, të njoftohen me këtë çështje; thonë mund të bëhen të shurdhër apo të ikin prej përgjegjësisë. Po kjo nuk është në rolin tonë si asamblistë. Dhe sot, para nesh, kjo çështje po prezantohet me një ndjeshmëri të veçantë. Kjo ndjeshmëri e ka për qëllim që ta shuajë debatin, mirëpo asnjë temë nuk është më e rëndësishme se kjo dhe, si e tillë, ajo nuk duhet të kalojë pa një debat publik. Ky debat duhet të udhëhiqet apo të nxitet nga këshilltarët komunalë; për këtë edhe jemi të thirrur. Nga ana ime, si që e kam shprehur edhe më parë, unë e kontestoj hapur ndërtimin e çerdheve të reja. Mungesa e seriozitetit të kryetarit të komunës duket që në dokumentin e tij të propozuar. Bëni me mend, kryetari nuk e ka marrë mundin as me e verifiku se me cilën "ç" shkruhet fjala çerdhe; thotë e keni me "q" të qenit dhe jo me "ç" të çekiqit. Unë mendoj se kemi mjaftueshëm objekte komunale për t'i shndërruar në çerdhe. Çdo secili prej nesh duhet ta kuptojë se një vend, i cili ka përparim zhvillimi, ekonominë përmes tregut të lirë mundohet t'i reduktojë shpenzimet e sektorit publik, me qëllim që t'i japë hapësirë rritjes së sektorit privat. Mos harroni se sektori publik nuk prodhon, por shpenzon, dhe të hyrat e tij janë të varura nga taksat e sektorit privat apo të vetë qytetarëve të tij. Këto duhet t'i kemi parasysh, se në të gjitha vendet perëndimore sektori publik është nga një deri në 5% të kapitalit shtetëror. Sa jemi sot duke e kuptuar rolin e sektorit publik dhe racionalizimin e tij? Ndërtimi i shumë objekteve në komunën tonë bënë rritjen e shpenzimeve bashkë me të, dhe mosshfrytëzimi efikas, nga ana tjetër, është dëm i jashtëzakonshëm kundrejt interesit të përgjithshëm.

z.Jakup Demiri: Te puna e vendimeve, është një arsytim sa për sy e faqe; ta tejkalojmë si dokument që është kthyer prapë. Dhe ne këtu, kur po flasim e kur po diskutojmë që dokumentet po kthehen prapë prej ministrisë, po nuk kemi mbledhje, nuk na kthehet dokumenti. Plus asaj, është dokument i çerdhes; edhe në KPF, edhe këtu kemi folë që dokumenti duhet të rregullohet mirë, se me u kthy, ka vonesa dhe i marrim do pika si kuvend komunal jo në rregull, pa fajin tonë. Me sa di unë, janë dy zyrtarë ligjorë në Komunën e Vitisë dhe kaq shumë dokumente kthehen. Nuk e di se çka po ndodh këtu. Te puna e çerdheve, e meriton me pasë një debat, se përnjëmend kemi shumë objekte shkollore që tash, për një kohë shumë të shkurtë, kanë me na mbetë thatë, se është numri në rënie i nxënësve. Dhe me këqyr cila është dobia e një objekti të ri, kur janë objektet, janë dy objekte, njëri në Drobesh dhe njëri në Qifllak, që janë adaptu dhe funksionojnë si çerdhe. Ndërsa kërkesat e qytetarëve për fëmijët me i çu në çerdhe janë jashtëzakonisht të

mëdha; edhe neve si asamblistë na thirrin me ndihmu. E dimë që ka mungesë të madhe të hapësirave për fëmijët me i sistemu nëpër çerdhe, po kjo që punohet pak edhe në aspektin e dokumenteve dhe legjislacionit, kjo është një brengë. Nuk është e arsyeshme; besoj që është mirë me të një kërkimfalje ata zyrtarët që i bëjnë këto dokumente, se i vonojnë.

z.Elham Emerllahu: Faleminderit kryesues. A hapët diskutim për pikën e rendit të ditës? Atëherë nuk e di pse iu ndërpre fjala assembleistit. Po më duket e tha Jakupi, e tha në fund, që është mirë ne mos me u ngut me të bësi gabime kur të marrim vendime, pa marrë parasysh rastin, por edhe këtë rastin konkret. Domethënë, është gabim shumë i ulët nëse ne nuk e dimë ku e kemi parcelën dhe për cilin objekt po flasim. Edhe tash Ministria me na e kthy vendimin... domethënë nuk kemi nevojë me u ngut. Është mirë me u sqaru zyra ligjore, institucionet tjera komunale, drejtoritë, dhe kur vjen një vendim mos me e marrë me ngut, sikur atëherë për ndryshimin e statutit të komunës.

z.Illir Zuka: Unë nuk pata plan me diskutu, se realisht dihet, është shfuqizim i një vendimi që kemi marrë ne, e kemi votu krejt kuvendi. Uroj që herën tjetër të vie pa këtë gabim, dhe të kalon për çerdhe. E dimë këta, po thojnë nuk ka nevojë, po unë besoj që ka nevojë, se çerdhja në Qifllak që është, është shumë e ngarkume, dhe është në të mirë të qytetarëve, që patjetër në pjesën e Sllatines të jetë edhe një çerdhe.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Sa për informacion, se po flitet që ky kuvend ka marrë shumë vendime jashtligjshëm. Jemi ndër komunat më së paku që kemi vendime jashtëligjshëm. E dhashë si informatë, të drejtën e keni me gjyku.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: aleminderit prej këshilltarëve që po i ngrisin shqetësimet lidhur me këtë çështje. Nuk dua me qenë avokat i zyreve ligjore, për shkak se kush e ka të bësi gabim e ka të bësi me vullnet të mirë. Tash momentalisht në ministri pranohen çerdhe të reja; kush ka projekt për çerdhe të re, edhe na në kontest të saj, me qëllim ndoshta i kemi ikë. E njëjta parcelë është në atë vend, është, por nuk është aty ku është e destinueme në PZHK. Në PZHK është i përfshim edhe objekti i zyrës së vendit. Tash kanë thanë: bëje aty ku e ke caktu me PZHK, që i thojsha që nuk lejojnë në këtë rast, se është e parapame. Për këtu, me konkuru, duhesh meremetim të asaj ndërtese me konkuru, që nuk është hap thirrja hala. Edhe ky ka qenë ai gabimi, i cili është bërë i qëllimshëm nga ana e tyne që e kanë shtrru kërkesën. Ndërsa Jakupi më tha se po e arsyeton sa për sy e faqe; unë nuk e di si arsyetohet propozim-vendimi për anulim, ndryshe kur e thamë të saktën që na ka kthy ministria që nuk je në konform me dokumentacionin. Shumë domethanëse është që e ke aprovu prej kuvendit, dmth PZHK; paska diçka ikje jashtë kësaj, jo. Në rast se ti din diçka, thuama që unë të përmirësohem; meqenëse nuk përmirësona, unë jam obligativ me t'i pru dokumentet, të cilat në terminologjinë juridike i thonë "vëllai i madh" në këtë rast, të cilët na ka kthy e ka thanë: nuk e ke konform ligjshmërisë dhe dokumentacionit që ke prodhu ti vetë si pushtet local. Përmirësoje, bjeri.

z.Jakup Demiri: Nënkyetar, dokumenti numër një, apo "kushtetuta" e një komune, është plani zhvillimor komunal. Nëse me qata nuk je konsultu si dokument i parë, me të tjerët nuk ke nevojë hiq me u konsultu. Aty e ke gabimin. Është dashtë me u bazu në të; pse e ke anashkalu atë? Se këtu kemi kërkun që e keni dokumentacionin në rregull, krejt; ka procesverbale, e keni dokumentacionin e saktë, të rregullum. Për këtë kemi folë edhe në KPF, se vonohet. Tani aty është një vendim për 2026; nëse nuk shkojnë dokumentet deri më 31 qershor, humb afati kalendarik, dhe këtë duhet me ditë. Për atë e kam — e tani ia gjuani fajin atyne.

z.Labinot Bislimi: Të gjitha këto çështja e çerdheve dhe sistemit edukativo-arsimor është çështja më e madhe në vend, jo vetëm në komunën tonë, e aq më tepër në komunën tonë. Unë besoj që ky fuqizim, shfuqizim, jam okej, janë përmbajtje ligjore, por çështja nuk është hiq aty. Dhe unë nuk besoj, përveç se duhet me thirrë seancë të jashtëzakonshme, që ju e premtoni po s'e bëni, se keni mu mundu me i ikë përmes këtij shfuqizimi dhe me sjellë edhe njëherë për fuqizim. Duke qenë se çështja është shumë e ndishme, ku Iliri po mundohet me na e atribu që ne jemi kundër çerdheve dhe kundër nevojës — ne jemi pro çerdheve, dhe po e përsëris që jam pro edhe 20 çerdhe me i bë në Viti, sepse ka nevojë, mirëpo çështja është: a kemi objekte të mjaftueshme apo jo në komunën e Vitisë, të cilat mundemi me i shndërru në çerdhe. Dhe unë nuk mendoj që përmes ndaljes së fjalës, se unë e kisha kry deri sa fole ti. Unë e kisha kry përmes ndërprerjes

së fjalës; po përkundrazi, kryesues, duhesh me qenë ti ai, bashkë me kryetarin e komunës dhe nënkryetarin, që duani me njetë këtë debat, se është debat shumë serioz.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Unë për këtë çështje që është serioze, thashë që mundesh me thirrë një seancë tjetër, e thirrimit dhe e diskutimit, ndërsa tani ne duhet të përmbahemi rendit të ditës, e kjo që po e shqyrton ti nuk ka të bëjë me rendin e ditës.

z.Labinot Bislimi: Çështja a jam tu folë unë për ujësjellës këtu. Jo. A jemi tu folë për ndonjë çështje tjetër, jemi tu folë për çerdhet. Pra, rendi i ditës janë çerdhet.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim për miratim. Pra, me 14 vota pro, 1 kundër, 4 abstenime miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë të rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Deklaratës mbështetëse për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Për këtë pikë dhe në KPF kemi diskutu. D.m.th shumë komuna tjera e kanë marrë, po edhe Qeveria e Kosovës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kjo iniciativë i ka ardhë kryesuesit të Kuvendit të Vitisë, për shkak se nëpër shumë kuvende komunale nuk ka dalë nga ana e ekzekutivit, por është si iniciativë në të gjithë Kosovën, në të gjitha kuvendet, me dalë me një deklaratë mbështetëse për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike. Mua më ka dokë që është diçka progresive që mundet me e bë edhe komuna e Vitisë; andaj është në domenin e juaj që ky dokument mu miratu apo mos me u miratu.

z.Yllka Qamili: Përsëritje për të gjithë të pranishmit. Pika që po e shqyrtojmë sot, unë mendoj që nuk duhet të jetë veç një deklaratë që kemi me votu edhe me miratu në Kuvend, po është edhe një realitet që shumë gra po e përjetojnë çdo ditë në politikë dhe në jetën publike. Atëherë, ne duhet të jemi të qartë se dhuna ndaj grave nuk është vetëm ajo fizike që është duke u ushtruar sot; ajo është duke ndodhur përmes fjalëve, ofendimeve, komenteve denigruese, mosrespektit ose edhe përjashtimit nga vendimmarrja. Këto raste nuk janë hiq të rralla në shoqërinë tonë dhe janë bërë goxha serioze, dhe për fat të keq janë fatkeqësi që janë duke u normalizuar prej shoqërisë sonë. Kur një grua po sulmohet për shkak të gjinisë së saj, kur nuk merret seriozisht apo tentohet me u hesht, aty po cenohet drejtpërdrejt dinjiteti i saj. E kur të cenohet dinjiteti i një gruaje, cenohet edhe institucioni ku ajo përfaqëson. Prandaj, kjo deklaratë që po diskutojmë tani është e domosdoshme, por nuk mjafton vetëm me u miratu, por duhet me u jetësu. E ne si Kuvend kemi përgjegjësi me vendos standarde të qarta të respektit në komunikim, mos me toleru gjuhë fyese ose nënçmuese ndaj askujt, e aq më pak ndaj grave; me largu menjëherë kur cenohet dinjiteti i një gruaje dhe me kriju hapësira të barabarta ku gratë flasin lirshëm. Pjesëmarrja e grave nuk është e drejtë vetëm formale; është thelb i një demokracie funksionale. Andaj është me rëndësi me theksu se ku ka vullnet ka edhe rezultat. Edhe në komunën tonë, nën udhëheqjen aktuale, jo politikisht, por kemi parë përkrahje konkrete për gratë. Kjo reflektohet qartë në drejtori dhe në sektorë të ndryshëm, si në QKMF, shkolla, çerdhe, ku roli i gruas është i dukshëm dhe aktiv. Kjo dëshmon që gruaje është e zonja, e aftë dhe plotësisht e përgatitur për udhëheqje dhe përfaqësim dinjitoz në çdo nivel institucional. Sot e kemi mundësinë me tregu që nuk i tolerojmë këto realitete, që nuk e normalizojmë nënçmimin dhe që dinjiteti i grave në këtë institucion është i paprekshëm. Në fund të kësaj, kjo nuk është vetëm çështje e grave; është çështje e respektit, barazisë dhe seriozitetit tonë si përfaqësues të qytetarëve. Andaj, le ta shohim këtë si një mundësi për fuqizimin e grave dhe zërimin e tyre.

z.Labinot Bislimi: Unë sapo konstatova një diskriminim të fjalës, pra zonjën e le me folë mbi 3 minuta, që të jemi korrekt. Kështu që për diskutim, ja bajmë diskutim, ja nuk bëjmë. Ligjëratat për të drejtat e grave, besoj që nuk kemi nevojë në këtu, asnjëra. Kjo është çështje shumë e rëndësishme, por ju për këtë punë e dimë si funksiononi.

z.Yllka Qamili: Nuk kam asgjë personale, por kur ke puna me fol për çështjet materiale, për toka, për parcela, për çerdhe krejt diskutojshim dhe patëm hapësirë me diskutu kur bëhet puna për çështjet shoqërore, që janë gratë në rend të parë. Krejt refuzojmë me fol ose me u bë zëri i dikujt tjetër, gjë që shumë gra kemi raste që vriten ose keqperdoren, ose keqtrajtohen.

z.Labinot Bislimi: Zonjë, as unë nuk kam personale me ty, kështu që, po te themë të drejtën që nuk po të njoftoj, po të shoh për herë të parë. Ajo që është me rëndësi për çështjen e barazisë gjinore, janë çerdhet, se çerdhet dhe sistemi arsimor është i lidhur drejtpërdrejt për barazinë gjinore dhe për të drejtat e grave.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Në një seancë të veçant diskutojmë për çerdhe. Mos të dalim prej rendit të ditës. Pasi që më nuk ka për debat, e qes në votim. Pra, me 20 vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Pyetje dhe përgjigje

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Pasi që unë sot udhëheq seancën, ju kisha lutë që rregullores të ju përmbaheni, ju kisha lutë që çdo këshilltarë të bëjë 2 pyetje. Kohën e keni 1 minut, por edhe replikën keni të drejtë 1 minut.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pyetja parë është, sa i keni ndihmu financiarisht shoqatat e dala nga lufta gjatë vitit 2025, dhe sa do t'i ndihmoni gjatë vitit 2026, dhe veçant prej shoqatave. Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve e ka një zyre që nuk i plotëson kushtet për atë shoqat. Tjetra pyetje te zjarrfikësat: sa punëtorë i keni marrë, që tani përfundon dhe muaji 6-të, dhe sa i keni kry obligimet ndaj atyre punëtorëve.

z.Jakup Demiri: Dua ta di: komuna a ka ndonjë dokument që e ka të pasqyrueme apo të analizueme sa projekte i ka të papërfunduara? E kam fjalën për projektet të cilat e kanë kalu dinamikën e afateve kohore. Sa duket, ka shumë, dhe kjo ka qenë edhe në vitet e kaluara. Po ashtu, sa nga projektet e kryera janë të papaguara për operatorët të cilët i kanë kry? Pyetja tjetër ka të bëjë me trotuarin në Smirë. Po flas për këtë trotuar, se është viti i pestë që është i papërfunduar. Janë pesë vite që disa nxënës aty kalojnë çdo ditë, shumica i bien me veturë, i bartin fëmijët në shkollën e Smirës, por disa ecin. Në atë trotuar ka gropa në mes, jo një, por janë 5–6 që shkojnë deri në 90 cm thellësi. Çdo ditë ata ekspozohen ndaj atij rreziku. Ka pasur edhe të lënduar aty. Është viti i pestë që kjo po zgjat, dhe prej rreth 3 vitesh unë e bëj këtë kërkesë vazhdimisht, por kurrë nuk është ndërmarrë asgjë.

znj.Elsa Jahija: Siç jemi të informuar, tani është hapur afati për aplikim për bursat studentore komunale. I kam analizuar me kujdes kriteret aktuale dhe mendoj që rregullorja ekzistuese e bursave ka nevojë për disa përmirësime, në mënyrë që mbështetja të jetë sa më e drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Si studente, e njoh nga afër rëndësinë që ka mbështetja institucionale për të rinjtë dhe ndikimin e saj në cilësinë e studimeve. Pikërisht për këtë arsye, gjatë kësaj periudhe kam pranuar shqetësime të shumta nga studentët lidhur me disa kriteret që vlerësohen si kufizuese. Një ndër to lidhet me kërkesën për dëshmi që aplikuesit të mos jetë i punësuar. Duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe faktin që shumë studentë detyrohen të angazhohen në forma të ndryshme pune për t'i përballuar shpenzimet e studimeve, konsideroj se ky kriter meriton të rishqyrtohet, në mënyrë që mbështetja të mos u pamundësohet atyre që realisht kanë nevojë. Po ashtu, vlerësoj se duhet të shqyrtohet me kujdes edhe mundësia e përfshirjes në aplikim e studentëve që ndjekin studimet në universitete të tjera publike, konkretisht në Universitetin Shtetëror të Tetovës, duke pasur parasysh që një numër i konsiderueshëm i studentëve nga komuna jonë studiojnë atje, veçanërisht në drejtime si mjekësia e përgjithshme. Mirëpo, për shkak se edhe atje ata trajtohen si studentë jashtë shtetit, ata nuk përfitojnë mbështetje nga të dyja anët. Duke marrë parasysh këto dhe nevojën për një trajtim më gjithëpërfshirës, propozoj që ky Kuvend, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të disa neneve të rregullores komunale për bursa, me qëllim që të krijohet një sistem më i drejtë dhe më gjithëpërfshirës.

znj.Ardita Hajdari: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Dua ta ngris një shqetësim të cilin e kam marrë nga shumë qytetarë lidhur me dëmtimet e infrastrukturës publike nga kompanitë punëkryese të

projekteve në komunë, përfshirë edhe ndërhyrjet nga KEDS-i. Të gjithë ne kemi parë se gjatë punimeve nga kompanitë e ndryshme po dëmtohet infrastruktura publike, dhe pas përfundimit të punimeve këto dëmtime nuk po rikthehen në gjendjen e duhur, por po lihen ashtu pa asnjë llogari. Prandaj kërkoj nga Komuna e Vitisë, veçanërisht nga Inspektorati, t'i inspektojnë këto punime dhe për çdo dëmtim të infrastrukturës publike të kërkohet llogari dhe përgjegjësi.

z.Elham Emerllahu: Kam një shqetësim dhe nuk e di a duhet me ju drejtu nivelit lokal apo atij qendror. Ka qenë një rast eklatant në Komunën e Vitisë, gjegjësisht në fshatin Lubishtë, dhe çuditërisht nuk është bërë e madhe kjo temë as në komunën tonë, as nga niveli lokal, as nga niveli qendror, e as nga kolegët e mi asambleistë, sidomos nga ju të Vetëvendosjes. Sepse dy fermerëve nga Lubishta, njërin prej të cilëve e kam takuar, ju kanë infektuar një numër i madh i kafshëve, diku 10–15 krerë lopë, nëse nuk gaboj. Agjencia e Veterinës së Kosovës ka deklaruar që nuk kemi kontratë me një operator privat për asgjësim, të cilin e kanë ata për këtë punë, dhe kjo çështje është votuar një muaj më parë. Sëmundja e tuberkulozit të kafshët qenka sëmundje ngjyëse edhe për njerëzit. Fermeri është detyruar me i karantinu lopët për një muaj rresht dhe nuk ka pasur asnjë reagim, as nga niveli qendror. E kam parë një deklaram të drejtorit të Bujqësisë në një televizion nacional. Mandej ka edhe asambleistë prej Lubishtes këtu; Majlinda, sa di unë, është agronome, kryetari i tyre i Vetëvendosjes është veteriner, ndërsa zv/ministri i Bujqësisë, asnjë deklaram. Në fund, Agjencia e Veterinës ka bërë një kontratë të shpejtë, i ka marrë kafshët dhe i ka asgjësuar. Tash pyetja është: a duhet me ngritë pak më shumë këtë çështje? Sepse puna e fermerëve është punë e ndjeshme. Ka mungesë, dhe shqyr Zotit që po afrohen e po mundohen me kriju ferma dhe me rritë numrin e tyre. Ne nuk po i trajtojmë qysh kanë me u kompensu, si kanë me u kompensu, dhe pse ka ardhë puna që ai fermer për një muaj me i karantinu kafshët e tij dhe askush mos me u përgjigj për këtë çështje.

znj.Mirjeta Hamiti: Po e paraqes një pyetje, por edhe një kërkesë që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e banorëve të fshatit Drobesh. Segmenti rrugor nga shkolla fillore, pra përreth shkollës e deri te varrezat e fshatit, vazhdon të jetë pa trotuar dhe pa ndriçim të mjaftueshëm. Kjo situatë paraqet rrezik të përditshëm, sidomos për nxënësit dhe këmbësorët që përdorin këtë rrugë çdo ditë, në mbremje. Mungesa e ndriçimit e bën këtë segment edhe më të pasigurt. Andaj kërkesa jonë është e qartë: ndërtimi i një trotuari përgjatë këtij segmenti, si dhe rivitalizimi i ndriçimit publik dhe vendosja e ulëseve për pushim për qytetarët, veçanërisht për të moshuarit. Ky nuk është vetëm një investim në infrastrukturë, por edhe një investim në sigurinë dhe në cilësinë e jetës së banorëve të Drobeshit. Andaj kërkoj nga ju që ta trajtoni me prioritet këtë kërkesë.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket pikës me diskutime dhe pyetje nga qytetarët tanë, unë dua me mbajt një fjalim, por është me kërkë përgjegjësi dhe ndryshime konkrete. Si përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje tashmë për 9 vite me radhë, kritika ime kryesore ka qenë mungesa e politikave të reja për qeverisjen lokale në Viti, duke marrë parasysh që mandati të cilin kemi fillu është mandati i katërt. Natyrisht që edhe ky mandat është fillu me qasjen konkrete, ose me pasqyrimin e punëve të njëjta, dmth pa ide konkrete dhe pa vendime të freskëta që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. Po du me fillu me marrë një shembull konkret: në Komunën e Fushë Kosovës, aty ku Lëvizja Vetëvendosje e ka fillu mandatin e saj qeverisës për herë të parë, brenda tre muajve të parë ka marrë vendim që me i nda 100 euro për fëmijët me Down syndrome dhe autizëm. Për komunën e Vitisë kjo ndoshta mundet me qenë një politikë shumë e thjeshtë, por besoni që është shumë e rëndësishme për ato familje. Nëse e bëjmë krahasimin, në komunën tonë për tre mandate me radhë kjo kategori është pothuajse e harruar. Data 21 mars në Komunën e Vitisë kalon me një postim në rrjete sociale dhe aty përfundon gjithçka. Pra, ajo nuk është përkujdesje institucionale, kjo është vetëm formalitet. Sa i përket temës së njëjtë, pra moskonkretizimit të politikave të reja, mua më duhet me përmend prapë temën e bursave studentore. Kemi parë së fundi që është hapë konkursi për aplikim për bursa. Sa i përket shumës, në Komunën e Vitisë për një vit ndahen 300 euro, shumë që nuk i mbulon as shpenzimet bazike, e lëre më të jetesës dhe të udhëtimit. Në anën tjetër, nëse marrim shembull Komunën e Mitrovicës, ku Lëvizja Vetëvendosje veç ka fillu mandatin e saj, vendimi i parë brenda tre muajve ka qenë rritja e bursës prej 630 në 720 euro, dmth është

rritë. Njëkohësisht është rritë edhe numri i aplikantëve. Çka duhet me theksu është se nëse bëjmë një matje të studentëve të Komunës së Vitisë dhe atyre të Mitrovicës për kilometra, studentët e Vitisë prej Vitisë në Prishtinë shpenzojnë më shumë. Pyetja është e thjeshtë: pse Komuna e Vitisë po bën vendime të përsëritshme dhe të vazhdueshme pa asnjë reflektim? Pse kemi vendime të njëjta pa asnjë ndryshim? Dhe pse po mungon vullneti për me ndërmarr hapa të rinj e të rëndësishëm që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve?

z.Lulzim Haxhiu: Kam një pyetje rreth puseteve, të cilat pothuajse në të gjitha rrugët e Komunës së Vitisë janë diku 10 centimetra më ulët se asfalti, si dhe për prerjen e asfaltit në disa vende ku rrugët nuk janë në gjendje të mirë. A ka ndonjë plan konkret për rregullimin dhe sanimin e tyre? Pyetja tjetër ka të bëjë me ndriçimin publik. Keni deklaru se janë në procedura të tenderimit. A është përfundu ky proces dhe kur pritet me fillu rregullimi, pasi po hyjmë në muajin e katërt pa ndriçim publik në disa lagje të Vitisë?

z.Hajdin Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam dy kërkesa prej qytetarëve të fshatit Skifteraj. Një kërkesë ka të bëjë me trotuarin në rrugën “Flakadani i Lirisë”. A do të ketë trotuar, sepse është një gjendje e vështirë për nxënësit që kalojnë aty çdo ditë? Kërkesa tjetër ka të bëjë me rrugën “Nuhi Zeneli”, e cila është në gjendje shumë të vështirë. A do të intervenohet më shpejt, sepse është një gjendje shumë e keqe?

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje rreth rrugës për skaj të lumit, e cila është e shtruar me kubëza si projekt. A është e përfunduar apo duhet të ndërmerret diçka në këtë rrugë, sepse në mbledhjet e kaluara është diskutuar shumë dhe ka pasur shumë ankesa, dhe ju i keni cekë se kalohet shumë me vështirësi. Prandaj, dikush e ka quajtur projekt të dështuar, por unë kam thënë se nëse nuk merret diçka në atë rrugë, nuk bëhet ndonjë përmirësim. Unë do ta quaja edhe si projekt, por edhe si punë të dështuar.

z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Elhami parashtroj një pyetje shumë të rëndësishme dhe konsideroj lidhur me sëmundjen e brucelozës dhe tuberkulozës, që është prezente jo në komunën e Vitisë, por në të gjithë rajonin e Anamoravës. Dëshiroj t’ju informoj se çështja e përcjelljes dhe menaxhimit të kësaj sëmundjeje është çështje ekskluzive e Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit. Është e vërtetë se edhe në komunën tonë është prezente kjo sëmundje, jo vetëm muajin e fundit, por mund të them që nga janari e deri më tani. Si Drejtori e Bujqësisë, edhe pse nuk e kemi të drejtën e plotë të informacionit, më 25.01.2026 i jam drejtuar Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit me një kërkesë, me e-mail, që të na informojnë si drejtori dhe si komunë lidhur me rastet që janë prezente në komunën tonë: sa është numri i tyre dhe cilat ferma e cilët pronarë të fermave janë të prekur nga kjo sëmundje. Asnjë informacion nuk e kemi marrë nga korrespondenca dhe përgjigjja. Si drejtori e Bujqësisë, kam kontaktuar inspektorët e veterinarisë dhe kam marrë informata të tilla. Këtë çështje e kemi sensibilizuar edhe përmes mjeteve të informimit, ku tri televizione nacionale kanë shfaqur interesim dhe kanë ardhur me marrë informacione të tilla. Unë, si drejtori e Bujqësisë, i kam kontaktuar fermerët, sepse kam bashkëndjesi me ta për humbjet që i kanë pasur. Sipas informacioneve që kemi, në Ministri ekziston një udhëzim administrativ që i kompenson këto sëmundje, por ata kanë edhe dëme të tjera përcjellëse si fermerë, sepse në fermat e tyre të prekura nuk e kanë të drejtën që, në momentin e përfundimit apo eliminimit të kësaj sëmundjeje në gjashtë muajt e ardhshëm, t’i marrin lopët dhe t’i vendosin aty. Sipas informacioneve që kam, vetëm në territorin e Komunës së Vitisë dhe rrethinë janë më shumë se 83 lopë të asgjësuar nga muaji janar. Në Komunën e Vitisë është një numër diku mbi 60, ndërsa së fundi janë 26 të asgjësuar në Komunën e Vitisë, përkatësisht në Lubishtë, Remnik, Skifteraj, Çifllak dhe Sllatinë. Është shqetësuese. Edhe më shqetësuese është forma se si janë detyruar t’i mbajnë nëpër ferma lopët e infektuara, për faktin se, sipas informacioneve që kemi marrë, Ministria, përkatësisht AVUK-u, i ka skaduar kontrata e operatorit që është marrë me transportin e tyre, dhe ata janë detyruar t’i mbajnë për ditë të tëra. Një çështje tjetër: inspektorët, siç më kanë informuar, kanë marrë mostra edhe të lopëve të tjera dhe janë në pritje të rezultateve. Kjo është informata që e kam unë. Shpresoj dhe uroj që sa më shpejt të

përfundojë kjo sëmundje, e cila, siç e dimë, është sëmundje ngjitëse edhe për njerëzit, dhe natyrisht të kalojë sa më shpejt dhe të përfitojnë fermerët.

z.Elham Emerllahu: Faleminderit, drejtor, për informatën. Është edhe më shqetësuese, sepse kam mendu vetëm për këtë muajin e fundit me rastin e Lubishtës që kanë qenë të infektuara. Ju po thoni që prej muajit janar kemi raste dhe që i jeni drejtuar Agjencisë së Veterinarisë. Por nuk e dëgjova kush i kompenzon këto raste. Paska shumë krerë lopë që qenkan asgjësu. A nuk kompensohen humbjet e tyre, të paktën për krerët e lopëve?

z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë: Ekziston një udhëzim administrativ të cilin e ka nxjerrë Ministria e Bujqësisë dhe, në bazë të atij udhëzimi, ata i kompensojnë. Por a i kompensojnë vërtet dhe sa është vlera e tyre, unë nuk mund të jap informata të tilla, sepse nuk i di. Por e di që kompensohen në bazë të moshës së lopëve që kanë qenë. Kompensimi është obligim i Ministrisë; e di që disa i kanë marrë. Sipas asaj që di unë, janë kompensuar rastet e muajit janar dhe sigurisht që do të vazhdojnë edhe tutje me kompensimin e fermerëve. Por edhe një herë po e përsëris: nuk mund të kompensohen të gjitha humbjet e fermerëve që janë shkaktuar, sepse është ai zinxhiri i humbjeve. Megjithatë, në gjithë këtë të keqe që ka ndodhë, është edhe një e mirë që një vlerë u kompensohet.

z.Arton Musliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Mendova që Iliri dhe ju të tjerët po më bëni ndonjë kompliment për shumicën e punëve që janë kryer, e jo për pakicën e punëve që kanë mbetë, por sidoqoftë. I nderuari z. Demiri, z. Zuka, z. Ademi, znj. Hamiti dhe znj. Arditi, kryesisht pyetjet dhe kërkesat lidhen me dy fusha: ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e infrastrukturës publike rrugore. Sa i përket ndriçimit publik, është e vërtetë që procedurat tenderuese rreth ndriçimit publik janë në përfundim e sipër dhe besoj që këtë javë nënshkruhet kontrata. Në momentin që nënshkruhet kontrata, do të dalim në terren. Është e vërtetë që kërkesa ka shumë për me intervenu në infrastrukturën e ndriçimit publik dhe jam i bindur që kemi me i kry. Sa i përket mirëmbajtjes së infrastrukturës publike rrugore, ne jemi duke punu vazhdimisht dhe duke intervenu përmes ekipeve dhe kontraktorëve privatë në mënyrë të vazhdueshme. Mirëpo numri i kërkesave për intervenim është shumë i madh dhe kompanitë kontraktore që ne i kemi të kontraktuara kanë një strategji të punës: i mbledhin disa raste, p.sh. për asfaltimin e gropave, dhe pastaj intervenojnë në mënyrë të përbashkët, me qëllim të ekonomizimit të kohës dhe shpenzimeve. Besoj që jemi në rrugë të mirë që qytetarëve të Komunës së Vitisë t'iu ofrojmë shërbime publike efikase dhe cilësore, si dhe mundësisht të përmirësojmë infrastrukturën publike ekzistuese.

z.Ilir Zuka: Drejtor, është e vërtetë që ke punu mirë, mirëpo pak ndoshta është ajo xhelozia, se gjithë ato postime që i ke bërë kanë qenë këndej urës, dhe po shpresojmë që vjen radha me dalë edhe andej.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. I nderuari Jakup, për t'ju përgjigjur lidhur me investimet kapitale dhe obligimet: investimet kapitale dhe obligimet kanë qenë 4 milionë e 576 mijë e 563 euro, të cilat kanë qenë të paraqitura në pasqyrat financiare. Ndërsa tani, obligime, një pjesë e tyre i kemi kryer te mallrat dhe shërbimet. Na kanë mbetë rreth 3 milionë euro. Sa i përket investimeve kapitale, 1 milion e 810 mijë euro, ndërsa subvencionet 91 mijë euro. Sa i përket projekteve sa janë të përfunduara, për besë as unë nuk kam informacione të sakta për prokurimin, por besoj që ata e sjellin atë informacion.

z.Jakup Demiri: Është mirë që për mbledhjen tjetër të vijë si pikë e rendit të ditës për t'u diskutuar puna e projekteve të papërfunduara, borxhi i komunës dhe i kompanive të cilat i kanë kryer punimet, por nuk i kanë marrë mjetet. Duke përfshirë dokumentet përcjellëse, duke filluar prej vitit 2024 dhe prej KAB-it të miratuar, që atëherë është bërë gabimi më i madh në komunë. Vazhdimisht kjo pjesë është degraduar dhe hendeku vetëm po thellohet. Është mirë me u bërë një analizë dhe me u diskutu në Kuvend, në mënyrë që të kemi informata të sakta dhe ta dimë saktë gjendjen e projekteve të papaguara dhe të projekteve të cilat nuk po marrin përfundim. Nuk e kam fjalën për pranim teknik, sepse pjesa më e madhe e projekteve, që janë pak më serioze, nuk kanë fare pranim teknik.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Jakup, sa i përket obligimeve, të gjitha janë të paraqitura cent më cent. Sa i kemi borgje dhe si barten të hyrat vetanake, i ke në përgjegjësi te pasqyrat financiare, që në seancën e kaluar besoj që edhe i kemi sqaruar. Për këto, ia përcjell edhe mesazhin, pse jo.

z.Jakup Demiri: eç ta kesh parasysh, drejtoreshë: na jemi këtu kuvendarë dhe duhet me e ditë të vërtetën. Ti po thu që i ki në pasqyra financiare, po në pasqyrat financiare disa punë që janë kry në Smirë nuk figurojnë. Ato punë janë kry edhe kanë me u pagu. Për atë po them që duhet me pas dokumentin edhe me e ditë ku e kemi gjendjen financiare për këto punë.

z.Labinot Bislimi: Për drejtorin e shërbimeve publike, një pyetje: Arton, të dy jemi të Verbanit dhe mali jonë, e di unë, nuk e di a e din ti, është i mbushur me plehna e mbeturina të lloj-llojshme. Para 2-3 viteve, nja 5 thasë i kam hjek vetëm nëpër mal, pa hi nëpër rrugë. A është përgjegjësi e drejtorisë së shërbimeve publike me i hjek mbeturinat në atë zonë dhe nëpër zona tjera malore apo pyjore?

z.Arton Musliu, drejtor: Unë jam shumë i lumtur që iniciativës së pushtetit lokal, qeverisjes lokale për pastrimin e hapësirave publike, janë tu iu përgjigj një numër i konsiderueshëm i qytetarëve nëpër të gjitha lokalitetet e komunës së Vitisë. Ky është një lajm i mirë, sepse tregon sensibilizimin rreth nevojës për ambiente të pastra dhe të shëndetshme. Rreth pyetjes suaj konkrete, nuk e di saktësisht, për shkak se një pjesë e pyjeve janë pronë e Agjencisë Pyjore të Kosovës. Duhet me u shiku në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, në mënyrë që ta dimë saktë përgjegjësinë se e kujt është kujdesi për pastërtinë apo mbeturinat në hapësirat konkrete.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Faleminderit prej të gjithëve për kontributin që dhatë për këtë pikë të rendit të ditës. Sa i keni ndihmu shoqatat e dalura nga lufta dhe shoqatat e familjeve të dëshmorëve, e di që i kemi ndihmu, por në shifra sakt nuk e di, Ekrem. Jo vetëm me mjete i kemi ndihmu, por edhe në forma të tjera, në organizim të protestave; bile sot i kanë porosit 2 autobusë që kanë shku në protestë – krejt ato janë mjete financiare. Sa punëtorë i keni marrë te zjarrfikësat, a i keni kry obligimet? E di që obligimet nuk i kanë kry krejt, por për sa muaj jemi nuk e di. Elsa, rregullorja ndryshohet, vyn një iniciativë, mundet me pasë edhe nga këshilltarët komunalë, në përputhje me punëtorët e drejtorisë së arsimit, ulen e përpilojnë rregullore tjetër. Por për këtë vit jemi obligativ me e zbatu rregulloren që është në fuqi, dhe ty po t'dukut ndoshta jo e pranueshme çështja e kriterëve – studenti i punësuar. Unë konsideroj që, si të punon studentin, ai s'ka ma me qenë student; na duhet me i ndihmu ata që s'kanë marrëdhënie pune. Tjetra, Universitetin e Tetovës e ka përjashtu rregullorja, se është jashtë shtetit të Republikës së Kosovës. Sa i përket shkatërrimit të infrastrukturës, gjithherë bëjmë përpjekje që inspektorët tanë me u rri kompanive përkatëse, gjegjësisht KEDS-it kësaj radhe, që me e rikthy gjendjen e mëparshme që e ka demolu apo shkatërru projektin në fjalë. Propozimi yt i lidhur me shtrimin e trotuarit dhe ndriçimin publik duhet me u shiku. Zakonisht nëpër lokalitete kemi shtru rrugët kryesore, se tash ka ngarkesë në përballim të buxhetit; nuk ka lokalitet që nuk e lyp çdo rrugë që është e asfaltume me u përcjell edhe me trotuar, por mundësitë buxhetore nuk kanë leju ma shumë. Rruga “Nuhi Zeneli” e di që është bukur e shkatërruar, ndërsa te “Flakadani i Lirisë” është një realitet që është bukur i frekuentum prej nxënësve dhe ka nevojë me i pa mundësitë tona. Në fund, bashkëvendësi im e shtroi një pyetje me vend rreth rrugës me kocka. Nuk është e pranuar; gjithherë është me premtime, Remzi, që do ta fillojmë dhe do ta rregullojmë në formën ma të mirë të mundshme. Jemi në pritje. Askush nuk e pranon që është një projekt i përfundum mirë, dhe unë kam thanë ashtu. Duhet me u ndërmarrë masa – ose me u bo si duhet, jo me hekë e me shtru asfalt, nuk kemi çka me diskutu alternativ tjetër. Afati kohor na ka lidhë, për shkak se pare nuk i kemi lëshu. Po thonë: “Lëshona paret për punën që kemi kry”, por na s'guxojmë me i lëshu, se me të vërtetë nuk i ngjan asaj që e kam ëndërru me pa aty. Veç kocka është, projekti tjetër nuk i ngjan asaj që kemi mendu. Besoj që do ta gjejmë një zgjidhje. Po lidhem te Labi: nëse e shikojmë të rëndën, pyjet dhe kodrat ku bëhet hudhja e mbeturinave, shumica janë në emër të Tefik Qangës. Sa kemi pas mundësi kemi intervenu, për shkak se ka qenë një sistem, ka pas një fabrikë në Ferizaj. Po e shohim edhe në Remnik – shumica e kodrave janë në emër të tij. Por lejimi i hudhjes së mbeturinave – na nuk mundemi me nejt anash e me thanë që është në emër të dikujt tjetër, kur është në territor të komunës së Vitisë. Mua më vjen mirë që po ka iniciativa për me pastru natyrën. Elham, nuk e ki

çare pa ju nënshtru rregullave që vinë nga lart, për shkak se jam dëmtu në aspekt familjar dhe personal. Ajo që është me rëndësi është që është ngrit çmimi i kompensimit. Atë vit kur unë kam pas rastin ka qenë përgjysmë; ata nuk e ndryshojnë përditë udhëzimin administrativ, e ndryshojnë kohë pas kohe. E di që ju kanë kompensu për krerët, për shumën nuk e di saktë, por me rëndësi është me u mbulu dëmi. Ajo që është brengosëse është se ata janë vazhdimisht në kontroll dhe kërkohen afate. Nëse kësaj radhe i kanë marrë mostrat, pas 45 ditëve vinë prapë. Nuk ju ik kjo, nëse don me pas një fermë të shëndetshme. Nuk do të thotë që janë të fundit ato kafshë; herën tjetër mundet me dalë edhe 3 tjera, zgjatet afati dhe shkon ndoshta deri në 1 vit e gjysmë. Është brengosëse që e kemi permanente atë sëmundje në komunën e Vitisë, që është në krejt Kosovën. Ajo ka ekzistuar gjithherë, dhe nuk merren masa preventive për me parandalu raste të tilla – momentalisht në Kosovë nuk po merren.

znj. Elsa Jahija: Më është dukë e pa drejtë kriteri tek punësimi i studentëve, se edhe vetë si studente e di që shumë studenta, pa dashtë ata vetë, detyrohen me punu për me i vazhdu studimet, tu i ditë kostot e larta financiare sot. Ndoshta për një familje nuk mundet me ja dalë për një student. Ka raste që punojn me kohë të caktume, por aty munden me figuru si të punësum, edhe më është dukë shumë e pa drejtë me u përjashtu prej bursës komunale, tue ditë që është veç një herë në vit që ipen dhe janë 300 euro; për një studnet janë të pa përballueshme. Edhe te universiteti i Tetovës e kam parë, e kam lexu rregulloren. E di që është jashtë, po tu e ditë që është një numër i konsiderushem nga komuna jonë që studiojn atje, edhe atje nuk përfitojn bursa për shkak që vinë jashtë shtetit, mendoj që është një iniciativë për t'u marrë me shtu në rregullore. Kam parë dhe praktikë te komunat tjera që kanë bërë atë dhe mendoj që është e drejtë edhe ata me i përfshi në bursa.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Mundemi ne me marrë iniciativën, e marrim. Dhe tjetra që mbeta borgjë Liridona, Liridonë, kur e përmende pse komuna e Viti e ka 300 euro, unë kam konsideru që është shumë më e mirë. 300 euro. Është viti i 3 apo i 4 që nuk e kemi përjashtu asnjë student të rregullt. Gjithë studentët të cilët kanë konkuru, pavarësisht viteve, ju kemi nda të gjithëve dhe kemi konsideru që është shumë më mirë 300 me ju nda krejtve sesa me kqyr tani edhe aspekti personal, familjar e partiak, janë shumë gjëra. Po kështu ata janë studenta dhe mundësitë buxhetore tona kanë qenë kaq dhe ju kemi dhënë të gjithëve. E përmende Lëvizja Vetëvendosje në Mitrovicë. E ka Guxo, nuk e keni ju. Unë nuk mundem me i marrë këshilltarët e Partia Demokratike e Kosovës, jam në koalicion, por janë PDK.

z.Ekrem Abazi: Unë mendova që do ta marr një përgjigje, por nënkryetari nuk po e ditka sa i kanë ndihmu familjarët e dëshmorëve dhe shoqatat e dalura nga lufta. Po unë kërkova edhe për zyrë për familjen e dëshmorëve, se zyra nuk e plotëson asnjë kusht; është aq e vogël sa vetëm ata për me nejt, se me ardh një delegacion i huj nuk ka ku hynë. Tash zyra ka sa dush. Na kur kemi ardhë sëfite, kur ka qenë komuna këtu, krejt qitu jemi sillë; tash këtu te shpia e Bardhës e Sokolit, atje komuna e re, këtu ka zyre sa dush, e te familjarët e dëshmorëve zyra e tyre në atë gjendje me rrinë kryesia e tyre është pak e tepërt. Hajde, nuk e di, ju dikush nga ju përgjegjës duhet me ditë sa janë financu gjatë vitit 2025 dhe sa kanë me marrë ndihmë financiare në vitin 2026.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Ekrem, ne ju kemi ndihmu, bile pak më shumë se që kemi pasë mundësi, po shifër të saktë thashë me të dhanë nuk e di. E di që kemi lëshu vendim për financim, e di që kemi mbulu kartelat familjare të cilët i kanë, e di që kemi pagu edhe autobusa për me shku në vizita të ndryshme. Megjithatë, saktësinë kur të thuash, unë duhet me ta dhanë shumën e saktë. Dhe drejtoresha e financave nuk e din përmendsh. Nuk po mundesh me thanë ti se ata i kanë kushtet e rënda të zyrës; zyrën e kanë fenomenale, shumë të mirë për sipërfaqe. Aty nuk është kuvend.

z.Ekrem Abazi: I keni marrë te zjarrfikësat punëtorët 100% për shkak të zgjedhjeve, për vota i keni marrë; atë kurrë nuk ki fjalë që më demanton që nuk i keni marrë për vota. E tani ata i kanë bërë 6 muaj, tash ju del kontrata; ju i keni keqpërdorë ata njerëz dhe familjarët e tyre. Sot ata njerëz kanë punu qe 6 muaj, lloj-lloj rreziku kanë pasë, kanë marrë veç 1 pagë prej 6 pagave — nuk është turp kjo? Ka punëtorë që ndoshta kurrë nuk vjen në punë e merr pagesa muj për muj. Mos koftë kështu, thuaj nuk është kështu.

z.Lulzim Haxhiu: Sa i përket zyrës së familjeve të dëshmorëve, hapësirën sa e ka aty: kur të mblidhet kryesia, 3 vetë duhet me nejt në këmbë e dy me u ul — aq ka hapësirë zyra. Dhe sa i përket financimit, brenda vitit i ipen pare financiare 490 euro për gjithë vitin, dhe unë sa e di, me këto paguhen kartelat.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Jo, nuk paguhen kartelat me ato para, ato janë veçmas.

z.Lulzim Haxhiu: Kartelat kushtojnë 13 euro për person, kështu që nuk mbulohen prej shoqatës rrallë herë, dhe shumica nuk i vazhdojnë, se dinë që janë me financim për çdo vit.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i Komunës: Qe 12 vite që i mbulojmë ato pagesa.

z.Lulzim Haxhiu: Unë jam aty në shoqatë, dhe sa e di unë, baci qemajl më ka thënë që me këto 500 uero qka ipen prej komunës me ato mbulohen kartelat.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Kur është puna te shoqata, është edhe një rregullore. Kryetari ka të drejtë, ose ekzekutivi me i dhanë deri 500 euro, ndërsa shoqatat në thirrje publike duhet me konkuru me projekte për me mujtë me përfitu më shumë. D.m.th edhe ligji i pengon pak.

z.Ekrem Abazi: Aty ku ju konvenon juve për interesa personale, gjeni lloj-lloj kodi, por ju e pshtjellni dhe jeni jargan i fortë, i mbuloni; ku aty duhet patjetër me gjetë një kodë, mos me lanë në këtë gjendje. Është turp për neve që, kur të kemi ndonjë interes prej familjeve të dëshmorëve, prej veteranëve të luftës, i qojmë në qiell me fjalë, por me punë kërkund hiq. Subvencione ka kryetari mbi 100 mijë euro, kur kam qenë unë delegat; tash ka më shumë. Ato subvencione diku jepen.

z.Basri Aliu (në mungesë te kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Rregullorja është që, kryetari mundet veç deri 500 euro me i dhanë. Duhet me ardh ajo në formë tjetër.

z.Ekrem Abazi: Ti me kallxon mu që nuk kemi kod, dhe nuk jepen subvencione. Po jepen, por nuk doni me i dhanë, se i jepni vetëm kur keni nevoj për ta.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i Komunës: Nuk ka vendim të kryetarit të Komunës mbi 490, se nuk ka të drejtë, nuk është ashtu si po thua.

z.Elham Emerllahu: Për drejtorin e rinisë, kulturës dhe sportit e pata një çështje. Gjithë jemi dëshmitarë i këtyre javëve të fundit të aktiviteteve sportive, sidomos të Vllaznisë së Pozheranit, pretendente për futjen në ligën e parë të futbollit. Të gjithë jemi krenarë dhe po mundohemi, në mundësitë dhe kapacitetet tona, me mbështet, të paktën me tifozllak. Por këto ditë kam parë disa fotografi, mandej kam shku e kam vizitu vetë. Është shumë për keqardhje me pa, më së pari, stadiumin e qytetit të Viti në një gjendje tmerruese. Nuk e di kush e ka të drejtën e menaxhimit të saj ose mbikëqyrjen e saj, por me ardhë stadiumi i qytetit të Vitisë për mua ka qenë tmerruese; nuk e kam besu që është ashtu. Cila është përgjegjësia dhe a e ka parapa drejtoria e kulturës dhe sportit ndonjë investim në stadiumin e Vllaznisë së Pozheranit?

z.Valmir Sahiti: I nderuar këshilltar komunal, i dëgjova shqetësimet tua shumë të arsyeshme. Gjendja rreth stadiumit të qytetit është e vërtetë dhe kjo gjendje ka ndodhë për shkak se klubi KF Vitia, pas privatizimit, pas një kohe e ka pezullu veprimtarinë e saj dhe stadiumi i qytetit nuk e ka pas një titullar për me u kujdes për këtë. Për këtë qëllim, bashkë me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe bashkë me kryetarin e komunës, së fundi kemi nënshkru një memorandum dhe së shpejti stadiumi i qytetit të Viti do të jetë çështje javësh kur do të fillojë të punohet në të dhe do të tentojmë me kthi në gjendjen sa më të mirë të mundshme brenda kapaciteteve tona. Po ashtu, rreth klubit KF Vllaznia e Pozheranit, është e vërtetë që me atë klub jemi tu krenu të gjithë, por edhe komuna e Viti është duke e mbështet. Klubi KF Vllaznia e Pozheranit është klubi më i mbështetur në nivel të komunës së Vitisë, por lirisht mundem me thanë që është klubi më i mbështetur edhe në nivel të Republikës së Kosovës krahas elitës ku garon; nuk ka klub në Republikën e Kosovës në ligën e dytë që mbështetet me kosto financiare më shumë se sa KF Vllaznia e Pozheranit. I ka 2 stadione: stadiumin kryesor dhe stadiumin ndihmës. Te stadiumi kryesor është e vërtetë që, përveç fushës së mirë, edhe ka nevojë për tribuna. Është hera e 4 që ju kam drejtu Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit rreth tribunave në stadiumin e KF Vllaznisë. Gjatë javës së ardhshme kam një takim me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, me theks të veçantë për 2 projekte më të rëndësishme për komunën e Viti: rreth palestrës sportive dhe tribunave të Vllaznisë së Pozheranit, dhe po besojmë që së shpejti kemi me i dhanë dritë dhe kuptim kësaj çështjeje.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, e kam thanë edhe më herët e po më bjen prap me e përsërit këtë shqetësim. Është interesant se çdo herë kur bëhet ndarja e minutazhës, shumicën e herave ekzekutivi e ka minutazhën shumë të zgjeruar; ka hapësirë për me të prezantim, po ka hapësirë me të edhe kritika. Në momentin kur ne e kemi minutazhën tonë për me të pyetje, menjëherë na thuani “a keni pyetje konkrete?”, ama ne për me ardhë deri te pyetja duhet me e të një elaborim. Përpos që nuk kemi media prezentë, sot vjen koha me të pyetje e nuk marrim përgjigje. Unë i pata dy pyetje e nuk mora përgjigje për asnjërën.

z.Jakup Demiri: Po flasim për bursat; te kriteret besoj që duhet disa kriterë me i hek, e ku me qenë fitues edhe studentët që janë në Universitetin e Tetovës: pse mos me qenë pjesë e përfitimit edhe ata? Një student që punon, ai ka nevojë më shumë për parë që me i përfundu studimet.

z.Labinot Bislimi: Te organizatat e dala nga lufta, unë e kam pas edhe në program zgjedhor për autonominë financiare edhe materialin e organizatave të dala nga lufta. Për mu është e pakuptueshme kjo lidhje ose kjo varësi prej organizatave të dala nga lufta dhe komunës, dhe kjo varësi ka çu edhe në raporte, si që i thonë, të divijume prej shtatit të tyre, sepse nuk e kanë ata mundësinë me qenë të pavarura prej partive politike. Kjo për mu është e papranueshme. Pavarësisht që thuhet këtu që ka një financim prej 490 euro vjetore, në realitet, në kuptimin material, duket se është shumë më i madh se sa kaq. Kjo është e dukshme, nuk keni çka me na fshef se shihet me sy. Aq më tepër që kjo po i bën me i diskreditu këto organizata të dala nga lufta, sepse duket qartë se këto kanë një varësi financiare dhe një raport i cili nuk ju takon as komunës së Vitisë, apo më konkretisht partive në pushtet. Dhe mendoj, dhe kjo është pyetja: Kur doni me e gjetë një zgjidhje me këto organizata të dala nga lufta, dhe me ju dhënë mundësi që me kriju ata autonomi, dhe jo varësi prej jush?

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Për me qenë ata autonom, duhet Parlamenti i Kosovës me rregullu. Komuna nuk ka kompetencë për me i rregullu këto.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i Komunës: Çështja të cilën po e shtroni ju, Ekremi tash edhe Labi. Jam ithtar i asaj që ato me qenë të depolitizuara dhe me ruajt atë kredibilitetin e vet, kënd e përfaqësojnë: se shoqata e familjeve të dëshmorëve përfaqëson gjakun, këta tjerët përfaqësojnë luftëtarët që kanë mbetë gjallë. Megjithatë, në Kosovë tash e kanë të një rregullore që ka ardh prej qendrës, që e përmendi Basriu, që dojnë me pasë një kontrollim detal të parasë publike. Thonë që çdo OJQ duhet të konkurojë në thirrjen që ka të drejtori për kulturë, rini dhe sport, dhe ata konkurojnë dhe thonë: “kosto jonë, hipotetikusht, vjetore e shpenzimeve të zyrës, shëtitjes etj., kushton kaq”, dhe konkurojnë. Ulet komisioni prej 5 anëtarëve dhe vendos për ndarjen e tyre. Por ajo që është me rëndësi: kemi pas problem me shumë OJQ, se ishin mësu me i marrë parat — jo të familjeve të dëshmorëve, po them të OJQ-ve dhe mos me dhanë llogari. Kemi pasë problem me drejtorin, deri sa i kemi shti në binarë: duhesh me sjellë raportin ku i ke hargju, për me mujt me konkuru vitin e dytë, se të shtin në listë të zezë, që kanë hi disa OJQ. Ne kemi përdor atë tolerancën njerëzore. Unë e kam thirrë edhe kryetarin e shoqatës së familjeve të dëshmorëve më herët dhe më ka thënë që nuk di si me konkuru. I kam thirr edhe shoqatën e të burgosurve politikë. Po e kërkon rregullorja — urdhëro — që mos të biem ne në vendime 490 euro, se edhe mua më ka dukë pak. Dhe krejt çka kemi mujtë ne është kaq, se nuk kemi mundësi më shumë.

z.Basri Aliu (në mungesë të kryesuesit e udhëheq këtë seancë): Pasi që nuk kemi të tjerë për diskutim, faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

2



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

75-04-2526			
02-402	/	01-435	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026

Viti 14.04.2026



DREJTORIA E FINANCAVE

Data/Datum/Date	14.04.2026
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Milihate Ajeti Drejtor i Drejtoris për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-mars 2026

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-mars 2026 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – mars 2026 janë inkasuar gjithësej të hyra vetanake në vlerë prej 184.510,38€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 14.25%, ndërsa Krahasuar me të hyrat për periudhën janar – mars të vitit 2025 të hyrat e vitit 2026 janë me të ulta për 26.707,01 €

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – mars të vitit 2026 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 7.099.162,97€, ndërsa shpenzimet janë: 6.598.950,00€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar- mars 2026 është 92,95% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

ixheti i Aprovuar, Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-mars 2026

Aprovim					
Kateg.&Ekonomik	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve
Pagat &Shtesat	10,870,225.00	0.00	0.00	5,280.18	10,875,505.18
Mall.&Sherbime	2,749,828.00	329,091.00	0.00	15,985.56	3,094,904.56
Komunali	290,000.00	0.00	0.00	0.00	290,000.00
Subvencione	500,000.00	220,000.00	0.00	8,309.42	728,309.42
Kapitale	2,619,502.00	745,569.00	0.00	134,505.69	3,499,576.69
	17,029,555.00	1,294,660.00	0.00	164,080.85	18,488,295.85

Alokimet					
Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1 Pagat &Shtesat	3,571,121.44	0.00	0.00	5,280.18	3,576,401.62
2 Mall.&Sherbime	883,845.17	0.00	0.00	15,985.56	899,830.73
3 Komunali	86,344.19	0.00	0.00	0.00	86,344.19
4 Subvencione	121,307.00	0.00	0.00	8,309.42	129,616.42
5 Kapitale	2,149,202.00	123,262.32	0.00	134,505.69	2,406,970.01
	6,811,819.80	123,262.32	0.00	164,080.85	7,099,162.97

Te paalokuara					
Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1 Pagat &Shtesat	7,299,103.56	0.00	0.00	0.00	7,299,103.56
2 Mall.&Sherbime	1,865,982.83	329,091.00	0.00	0.00	2,195,073.83
3 Komunali	203,655.81	0.00	0.00	0.00	203,655.81
4 Subvencione	378,693.00	220,000.00	0.00	0.00	598,693.00
5 Kapitale	470,300.00	622,306.68	0.00	0.00	1,092,606.68
	10,217,735.20	1,171,397.68	0.00	0.00	11,389,132.88

Shpenzimet						
Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit
1 Pagat &Shtesat	3,571,121.44	0.00	0.00	2,110.00	3,573,231.44	99.91%
2 Mall.&Sherbime	782,500.33	0.00	0.00	381.48	782,881.81	87.00%
3 Komunali	74,016.26	0.00	0.00	0.00	74,016.26	85.72%
4 Subvencione	119,743.31	0.00	0.00	0.00	119,743.31	92.38%
5 Kapitale	1,838,209.86	123,262.32	0.00	87,605.00	2,049,077.18	85.13%
	6,385,591.20	123,262.32	0.00	90,096.48	6,598,950.00	92.95%

Diferenca Alokim-Shpenzim

Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1 Pagat &Shtesat	0.00	0.00	0.00	3,170.18	3,170.18
2 Mall.&Sherbime	101,344.84	0.00	0.00	15,604.08	116,948.92
3 Komunali	12,327.93	0.00	0.00	0.00	12,327.93
4 Subvencione	1,563.69	0.00	0.00	8,309.42	9,873.11
5 Kapitale	310,992.14	0.00	0.00	46,900.69	357,892.83
	426,228.60	0.00	0.00	73,984.37	500,212.97

Diferenca Aprovim-Shpenzim

Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1 Pagat &Shtesat	7,299,103.56	0.00	0.00	3,170.18	7,302,273.74
2 Mall.&Sherbime	1,967,327.67	329,091.00	0.00	15,604.08	2,312,022.75
3 Komunali	215,983.74	0.00	0.00	0.00	215,983.74
4 Subvencione	380,256.69	220,000.00	0.00	8,309.42	608,566.11
5 Kapitale	781,292.14	622,306.68	0.00	46,900.69	1,450,499.51
	10,643,963.80	1,171,397.68	0.00	73,984.37	11,889,345.85

Pasqrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	10,875,505.18	3,576,401.62	3,573,231.44	7,302,273.74	3,170.18	99.91%
2	Mallra dhe sherbime	3,094,904.56	899,830.73	782,881.81	2,312,022.75	116,948.92	87.00%
3	Subvencione	728,309.42	129,616.42	119,743.31	608,566.11	9,873.11	92.38%
4	Komunal	290,000.00	86,344.19	74,016.26	215,983.74	12,327.93	85.72%
5	Shpenzime kapitale	3,499,576.89	2,406,970.01	2,049,077.18	1,450,499.51	357,892.83	85.13%
	Gjithesëjt	18,488,295.85€	7,099,162.97€	6,598,950.00€	11,889,345.85€	500,212.97€	92.95%

Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	2,136,666.72
11121	Tatimi në të ardhurat personale	223,615.17
11131	Kontributi pensional - punëtorit	170,039.50
11151	Sindikata	10,303.87
11152	Odat Profesionale	4,526.25
11211	Pervoja e punes	168,052.96
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	170,039.50
11411	Shtesa e veçant për të zgjedhurit	2,304.21
11413	Shtesat e performances	672,516.19
11431	Kujdestaria,puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes	14,934.34
11611	Shtesat tranzitore	232.73
	Totali i pagave	3,573,231.44
13130	Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit	5,884.98
13132	Akomodimi per udhetime zyrtare brenda vendit	580.00
13140	Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit	1,429.20
13141	Para xhepi/meditje per udhetime zyrtare jashte vendit	1,054.00
13142	Akomodimi per udhetime zyrtare jashte vendit	237.00
13210	Energjia elektrike	59,620.59
13220	Sherbimet e ujesjelisit dhe kanalizimit	4,546.07
13230	Mbeturinat	6,393.25
13250	Telefonia Fikse	3,456.35
13310	Interneti	1,123.20
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	185,540.43
13440	Sherbimet keshilldhenses dhe profesionale	186,592.19
13445	Sherbimet e veqanta - konsulente dhe kontraktor individual	3,204.39
13450	Sherbimet e shtypjes / printimit	17,539.00
13460	Sherbime kontraktuese tjera	6,773.20

13470	Sherbimet teknike	1,995.00
13509	Pajisje tjera	16,185.50
13610	Furnizimet per zyre	9,792.01
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	7,495.72
13630	Furnizimet mjekesore	566.54
13760	Drute dhe prodhimet e drurit per ngrohje	5,390.00
13780	Derivatet per automjete, gjenerator dhe makineri	5,069.26
13950	Regjistrimi i automjeteve	710.00
13951	Sigurimi i automjeteve	936.88
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	230.00
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	4,305.00
14022	Mirembatja e ndertesave administrative dhe afariste	98,115.68
14032	Mirembatja e rrugeve lokale	145,453.38
14040	Mirembatja e teknologjis informative dhe te komunikimit	1,336.50
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe pajisjeve	25,195.75
14060	Mirembatja rutinore	36,038.00
14310	Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit	14,109.00
	Totali per sherbimeve mallra dhe komunali	856,898.07
200	Subvencionet dhe transfere	119,743.31
	Totali i subvencioneve	119,743.31
300	Investime kapitale	1,143,143.30
34000	Pagesat sipas vendimeve gjyqesore	905,933.88
	Totali i investimeve kapitale	2,049,077.18
	Gjithsej shpenzimet	6,598,950.00 €

Inspeksioni
Kodi 16665

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	87,886.00	28,826.40	28,826.40	59,059.60	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	70,000.00	11,542.20	10,042.20	59,957.80	1,500.00	87.00%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	157,886.00 €	40,368.60 €	38,868.60 €	119,017.40 €	1,500.00 €	96.28%

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	17,709.27
11121	Tatimi në të ardhurat personale	1,912.12
11131	Kontributi pensional - punëtorit	1,372.67
11151	Sindikata	31.62
11211	Pervoja e punes	1,174.89
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	1,372.67
11413	Shtesat e performances	5,253.16
	Totali i pagave	28,826.40
13460	Sherbimet kontraktuese tjera	5,042.20
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afaris	5,000.00
200	Totali për shërbimeve dhe mallra	10,042.20
	Subvencionet dhe transfere	0.00
300	Totali i subvencioneve	0.00
	Investime kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	38,868.60 €

Zyra e Kuvendit Komunal
Kodi 16933

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	262,830.00	81,249.45	81,249.45	181,580.55	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	12,000.00	1,500.00	0.00	12,000.00	1,500.00	0.00%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	274,830.00	82,749.45	81,249.45	193,580.55	1,500.00	98.19%

Shpenzimet e zyrës së Kuvendit Komunal

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	53,305.83
11121	Tatimi në të ardhurat personale	4,795.07
11131	Kontributi pensional - punëtorit	3,854.93
11211	Përvoja e punes	1,718.00
11311	Kontributi pensional - punëdhënësit	3,854.93
11411	Shtesa e veçant për të zgjedhurit	2,304.21
11413	Shtesat e performances	11,416.48
	Totali i pagave	81,249.45
	Totali për shërbimeve dhe mallra	0.00
200	Subvencione dhe transfere	
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime Kapitale	0.00
	Totali i Investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	81,249.45 €

**Buxhet e financa
Kodi 17533**

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	233,543.18	73,493.02	70,877.84	162,665.34	2,615.18	96.44%
2	Mallra dhe shërbime	75,559.86	30,277.56	11,095.68	64,464.18	19,181.88	36.65%
3	Subvencione	5,727.11	5,727.11	0.00	5,727.11	5,727.11	0.00%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	3,239,572.04	2,246,965.36	1,920,440.18	1,319,131.86	326,525.18	85.47%
	Gjithsej	3,554,402.19 €	2,356,463.05 €	2,002,413.70 €	1,551,988.49 €	354,049.35 €	84.98%

Shpenzimet - Buxhet e Financa 17533

Kodi	Pershkrimi	Shuma
11111	Paga neto	42,682.12
11121	Tatimi në të ardhurat personale	4,249.89
11131	Kontributi pensional - punëtorit	3,274.64
11151	Sindikata	126.76
11211	Pervoja e punes	4,092.58
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	3,274.64
11413	Shesat e performances	13,177.21
	Totali i pagave	70,877.84
13130	Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit	381.48
13141	Para xhepi/meditje per udhetime zyrtare jashte vendit	104.00
13440	Shërbime keshilldhënese dhe profesionale	3,622.69
13450	Shërbimet e shtypjes /printimit	1,650.00
13610	Furnizimet per zyre	4,445.01
14310	Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit	892.50
	Totali për shërbime dhe mallra	11,095.68
200	subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime Kapitale	1,014,506.30
34000	Pagesa sipas vendimeve gjyqesore	905,933.88
	Totali i investimeve kapitale	1,920,440.18
	Gjithsej shpenzimet	2,002,413.70 €

Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjencia
Kodi 180

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	329,153.00	104,935.66	104,935.66	224,217.34	0.00	100.00%
2	Malira dhe sherbime	1,185,684.00	476,483.03	452,980.04	732,703.96	23,502.99	95.07%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	157,200.00	45,573.17	40,154.53	117,045.47	5,418.64	88.11%
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	1,672,037.00 €	626,991.86 €	598,070.23 €	1,073,966.77 €	28,921.63 €	95.39%

Shpenzimet - Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjencia 180

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	59,408.48
11121	Talimi në të ardhurat personale	6,623.28
11131	Kontributi pensional - punëtorit	4,996.97
11151	Sindikata	79.06
11211	Pervoja e punes	6,214.68
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	4,996.97
11413	Shtesat e performances	19,480.42
11431	Kujdestaria, puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes	3,135.80
	Totali i pagave	104,935.66
13210	Energjia elektrike	33,233.80
13220	Sherbimet e ujeshillsit dhe kanalizimit	1,460.99
13230	Mbeturinat	3,329.85
13250	Telefona Fiks	2,129.89
13440	Sherbimet keshilledhense dhe profesionale	180,969.50
13450	Sherbimet e shtypjes /printimit	3,310.00
13509	Pajisje tjera	2,634.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	335.00
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	110.00
14022	Mirembalja e ndertesave administrative dhe afariste	84,130.16
14032	Mirembalja e rrugeve lokale	145,453.38
14060	Mirembalja rutinore	36,038.00
	Totali për shërbime malira dhe komunali	493,134.57
200	Subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	598,070.23 €

Zyra e komuniteteve

Kodi 19865

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	27,794.00	9,297.35	9,297.35	18,496.65	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	1,000.00	0.00%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	28,794.00	10,297.35	9,297.35	19,496.65	1,000.00	90.29%

Shpenzimet - Zyra e Komuniteteve - 19865

Kodi	Përshkrimi	Shuma
1111	Paga neto	5,388.62
1112	Tatimi në të ardhurat personale	580.21
1113	Kontributi pensional - punëtorit	442.72
1115	Sindikata	12.29
1121	Pervoja e punes	661.63
1131	Kontributi pensional - punëdhënsit	442.72
1141	Shtesat e performances	1,769.16
	Totali i pagave	9,297.35
	Totali për shërbime dhe mallra	0.00
200	Subvencione dhe transfera	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investimet Kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	9,297.35 €

11

Bujqësi pylltari dhe zhvillim rural
Kodi 47033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	56,188.00	19,229.01	18,674.01	37,513.99	555.00	97.11%
2	Mallra dhe shërbime	10,000.00	1,680.00	680.00	9,320.00	1,000.00	40.48%
3	Subvencione	352,582.31	74,249.31	71,121.31	281,461.00	3,128.00	95.79%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	418,770.31 €	95,158.32 €	90,475.32 €	328,294.99 €	4,683.00 €	95.08%

Shpenzimet - Bujqësia 47033

Kodi	Përshkrimi	Shuma
1111	Paga neto	11,261.53
1121	Tatimi në të ardhurat personale	1,167.58
1131	Kontributi pensional - punëtorit	889.24
11211	Pervoja e punes	769.06
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	889.24
11413	Shtesat e performances	3,697.36
	Totali i pagave	18,674.01
13140	Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit	450.00
13141	para xhepi/meditjet per udhetime zyrtare jashte vendit	230.00
	Totali për shërbime mallra	680.00
200	Subvencione	71,121.31
	Totali i subvencioneve	71,121.31
300	investime kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	90,475.32 €

Gjeodezi, kadaster, pron
Kodi 65165

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	71,039.00	20,901.75	20,901.75	50,137.25	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	10,000.00	1,898.09	898.09	9,101.91	1,000.00	47.32%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	81,039.00 €	22,799.84 €	21,799.84 €	59,239.16 €	1,000.00 €	95.61%

Shpenzimet - gjeodezi, kadaster, pron - 65165

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	12,284.12
11121	Tatimi në të ardhurat personale	1,282.14
11131	Kontributi pensional - punëtorit	995.34
11151	Sindikata	65.74
11211	Pervoja e punes	1,248.81
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	995.34
11413	Shtesat e performances	4,030.26
	Totali i pagave	20,901.75
13950	Regjistrimi i automjeteve	185.00
13951	Sigurimi i automjeteve	623.09
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	90.00
	Totali për shërbime dhe mallra	898.09
200	Subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	21,799.84 €

Planifikimi urban dhe mjedisi
Kodi 660

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	54,005.00	15,347.80	15,347.80	38,657.20	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	55,000.00	11,897.04	10,897.04	44,102.96	1,000.00	91.59%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	109,005.00 €	27,244.84 €	26,244.84 €	82,760.16 €	1,000.00 €	96.33%

Shpenzimet - Planifikimi urban dhe mjedisi 660

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	9,005.67
11121	Tatimi në të ardhurat personale	1,011.63
11131	Kontributi pensional - punëtorit	730.84
11151	Sindikata	47.11
11211	Pervoja e punes	944.39
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	730.84
11413	Shtesat e performances	2824.46
11431	Kujdestaria, puna gjate nates dhe puna jashte orarit te pu	52.86
	Totali i pagave	15,347.80
13445	Sherbimet e veçanta -konsulente dhe kontraktor individua	1,911.52
14022	Mirembajtja e ndertesave administrative dhe afariste	8,985.52
	Totali për shërbime dhe mallra	10,897.04
200	Subvencione dhe transfera	0
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	0
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	26,244.84 €

Shëndetësia - kodi 730

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	1,573,871.00	478,164.63	478,164.63	1,095,706.37	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	847,235.00	206,086.00	195,326.93	651,908.07	10,759.07	94.78%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	52,800.00	16,021.02	9,560.01	43,219.99	6,441.01	59.80%
5	Shpenzime kapitale	60,000.00	30,000.00	24,685.00	35,315.00	5,315.00	82.28%
	Gjithsej	2,533,906.00 €	730,271.65 €	707,756.57 €	1,826,149.43 €	22,516.08 €	96.92%

Shpenzimet - Shendetesi 730

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	270,415.92
11121	Talimi në të ardhurat personale	31,650.34
11131	Kontributi pensional - punëtorit	22,769.73
11151	Sindikata	1,173.17
11211	Pervoja e punes	27,025.50
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	22,769.73
11152	Odat Profesionale	4,526.25
11413	Shësat performances	86,626.28
11431	Kujdestaria,puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes	11,207.71
	Totali i pagave	478,164.63
13210	Energjia elektrike	7,332.05
13220	Sherbimet e ujesjelisit dhe kanalizimit	1,174.27
13230	Mbeturinat	580.20
13250	Telefonia fikse	493.49
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	185,120.43
13450	Sherbimet e shtypjes /printimit	3,134.00
13509	Pajisje tjera	3,200.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	75.00
14050	Mirembajtja e mobiljeve dhe paisjeve	3,797.50
	Totali për shërbime mallra dhe komunali	204,906.94
200	Subvencione dhe Transfera	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	24,685.00
	Totali i investimeve kapitale	24,685.00
	Gjithsej shpenzimet	707,756.57

Sherbimet Sociale
Kodi 75661

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	131,055.00	35,500.43	35,500.43	95,554.57	0.00	100.00%
2	Mallra dhe sherbime	50,000.00	15,471.54	12,202.54	37,797.46	3,269.00	78.87%
